



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE



NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE

RAPORTI VJETOR 2014



**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT**

RAPORTI VJETOR 2014

PËRMBAJTJA

1. HYRJA	7
2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA	8
2.1. Historiati i NJIF-K	8
2.2. Detyrat	9
2.3. Misioni	9
2.4. Vizioni	9
2.5. Buxheti dhe Prokurimi	10
2.5.1. Buxheti.....	10
2.5.2. Aktivitetet e Prokurimit.....	11
2.6. Organizimi i NJIF-K	11
2.6.1. Mbikëqyrja e NJIF-K.....	11
2.6.2. Burimet njerëzore dhe Struktura organizative.....	11
3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT	14
3.1. Zhvillimi i kornizës ligjore	14
3.2. Aktet nënligjore	14
3.2.1. Udhëzimet Administrative.....	14
3.2.2. Procedurat Standarde të Veprimit.....	15
4. PERFORMANCA E NJIF KOSOVË	16
4.1. Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare	16
4.1.1. Të dhënat dhe raportet e procesuara.....	17
4.1.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta.....	18
4.1.3. Raportet e transaksioneve të dyshimta për Financim të Terrorizmit.....	22
4.1.4. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG).....	22
4.1.5. Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme (Monitorimi special i transaksioneve të veçanta).....	24
4.1.6. Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës.....	24
4.1.7. Ngrirja e transaksioneve bankare.....	25
4.1.8. Sistemi Elektronik i pranimit të RTD-ve dhe RTG-ve.....	26
4.1.9. Kërkesat e OJQ-ve për përjashtim nga ndalesat ligjore.....	26
4.2. Analizimi dhe Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek autoritetet kombëtare dhe homologët ndërkombëtar	27
4.2.1. Analizimi i raporteve të inteligjencës.....	27
4.2.2. Hapja e rasteve me iniciativë të NJIF-K.....	27
4.2.3. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek institucionet vendore dhe homologët ndërkombëtar.....	28
4.2.4. Kërkesat për informata nga institucionet vendore dhe homologët ndërkombëtar.....	30
4.3. Inspektimi i pajtueshmërisë	32
4.4. Informatat kthyese	34
4.4.1. Informatat kthyese nga Institucionet e zbatimit të ligjit.....	34
4.4.2. Informatat kthyese për subjektet raportuese.....	35
4.5. Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve	35
4.5.1. Implementimi i Programit të Trajnimeve.....	37
4.5.2. Objektivat e Strategjisë së Trajnimit.....	37
4.5.3. Cikli i zhvillimit të trajnimit.....	37
4.5.4. Struktura e programit të trajnimit.....	38
4.6. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes	39



4.6.1. Konferenca Ndërkombëtare.....	39
4.7. Publikimi i Tipologjive.....	40
4.8. Rritja e kapacitetit të NJIF.....	40
4.8.1. Teknologjia Informative.....	40
4.8.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NJIF-K.....	42
5. BASHKËPUNIMI VENDORË DHE NDËRKOMBËTAR	45
5.1. Bashkëpunimi dhe koordinimi kombëtar.....	45
5.1.1. Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale	47
5.1.2. Memorandumet e Mirëkuptimit	47
5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont.....	48
5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve	48
5.2.2. Bashkëpunimi regional.....	50
5.2.3. Memorandumet e Mirëkuptimit	51
5.2.4. Procesi i Anëtarësimit në organizata ndërkombëtare	52
5.2.5. Egmont Group	53
5.2.6. Takimi i dytë i grupit të përdoruesve të goAML	55
6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT	56
6.1. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018.....	56
6.2. Vlerësimi Rrezikut Sektorial 2014.....	57
6.3. Mekanizmi kombëtar i menaxhimit të rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.....	58
7. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE	60
7.1. Bashkëpunimi me EULEX-in.....	60
7.2. Projektet e financuar nga BE-ja.....	60
7.3. Projekti i BE&KE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë PECK”	61
7.3.1. Cikli i dytë (II) i vlerësimit mbi pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT).....	61
7.3.1.1. Vizita në teren e ekipit të vlerësimit të projektit PECK në Kosovë	62
7.3.1.2. Takim mes autoriteteve të Kosovës dhe ekipit të vlerësimit në Strasburg63	
7.3.1.3. Takim Plenar i PECK për raportet e vlerësimit	64
7.3.1.4. Seminar mbi mbledhjen e të dhënave, mirëmbajtjen dhe raportimin e statistikave për qëllime të vlerësimit	64
7.3.1.5. Konferenca Ndërkombëtare mbi Përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.....	65
7.4. Mbështetja nga Thesari i Shteteve të Bashkuara	66
8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K 2015-2017.....	67



LISTA E TABELAVE

1. *Tabela 1 - Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2014*
2. *Tabela 2 - Struktura e stafit të NJIF-K*
3. *Tabela 3 - Personeli sekondar i NJIF-K*
4. *Tabela 4 - Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2014*
5. *Tabela 5 - Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2011-2014*
6. *Tabela 6 - Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për PP dhe FT të pranuar nga NjIF 2013-2014*
7. *Tabela 7 - RTG të raportuara për periudhën 2011-2014*
8. *Tabela.8 - Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) sipas sektorëve*
9. *Tabela 9 - Transaksionet e raportuara përmes sistemit online të raportimit*
10. *Tabela 10 - Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme*
11. *Tabela 11 - Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës*
12. *Tabela 12 - Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit*
13. ***Tabela 13 - Kërkesat e OJQ-ve për lirim të njëhershëm apo të vazhdueshëm***
14. *Tabela 14 - Rastet e Hapura 2014*
15. *Tabela 15 - Rastet e hapura me iniciative të NJIF-K sipas burimit 2014*
16. *Tabela 16 – Rastet e hapura me iniciative të NJIF-K 2011-2014*
17. *Tabela 17 - Raportet e shpërndara të inteligjencës 2011-2014*
18. *Tabela 18 - Raportet e shpërndara të inteligjencës referuar në institucione përkatëse 2013-2014*
19. *Tabela 19 - Kërkesat për informata të pranuar në NJIF-K 2011-2014*
20. *Tabela 20 - Kërkesat për informata të shpërndara nga NJIF-K 2011-2014*
21. *Tabela 21 – Inspektimi i Pajtueshmërisë 2014*
22. *Tabela 22 – Trajnimet e mbajtura me Subjektet Raportuese*
23. *Tabela 23 - trajnimet kryesore vendore të ndjekura nga stafi i NJIF-K*
24. *Tabela 24 - Trajnimet kryesore ndërkombëtare të ndjekura nga stafi i NJIF-K*
25. *Tabela 25 - Kerkesat për informata (RFI) të parashtruar nga institucionet bashkepunuese të NJIF-K*
26. *Tabela 26 - Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2011-2014*
27. *Tabela 27 - Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NjIF-K 2014*
28. *Tabela 28 - Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NjIF-K*
29. *Tabela 29 - Informacioni Spontan i shpërndarë nga NjIF-K 2013-2014*
30. *Tabela 30 - Kërkesat e NJIF-K drejtuar FIU tjera homologe 2014*
31. *Tabela 31 - Memorandumet e Mirëkuptimit me FIU ndërkombëtare*

LISTA E GRAFIKËVE

1. *Grafiku 1 - Përbërja e stafit të NJIF-K*
2. *Grafiku 2 – Numri i raporteve të procesuara përmes sistemit elektronik dhe online 2014*
3. *Grafiku 3 - Numri i RTD-ve të raportuara*
4. *Grafiku 4- Numri i RTD-ve të raportuara në 2014 sipas sektorëve*
5. *Grafiku 5- RTD të raportuara në vitet 2013 dhe 2014 sipas sektorëve*
6. *Grafiku 6 - RTD e pranuar për Pastrim të parave dhe financim të terrorizmit 2014*
7. *Grafiku 7 - RTG të pranuar*
8. *Grafiku 8 - Sistemi Elektronik i pranimi të RTD-ve dhe RTG-ve*
9. *Grafiku 9 – Rastet e propozuara*
10. *Grafiku 10 - Raportet e shpërndara të inteligjencës në vitin 2014*
11. *Grafiku 11 - Kërkesat për informata të pranuar dhe shpërndara nga NJIF-K*

LISTA E SHKURTESAVE

NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
PFT	Parandalimi i Financimit të Terrorizmit
LPP/LFT	Luftimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit
AIF	Raporti i informacioneve shtesë
AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar
AKI	Agjensioni Kosovar për Inteligjencë
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
ATK	Adminstrata Tatimore e Kosovës
AKK	Agjencia kundër Korrupsionit
BE	Bashkimi Europian
BQK	Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës
B & S	Implementuesi i Projektit të BE
DK	Dogana e Kosovës
EGMONT	Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
EULEX	Misioni i Bashkimit Europian për sundimin e ligjit në Kosovë
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
goAML	Sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IKKE	Instituti Kundër Krimeve Ekonomike
ILECU	Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit
KE	Këshilli i Europës
MF	Ministria e Financave
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
OJQ	Organizatat Joqeveritare
PEP	Personat e Ekspozuar Politikisht.
PECK	Projekti i BE&KE Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë
PK	Policia e Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
RTD	Raporti i Transaksionit të Dyshimtë
RTG	Raporti i transaksionit në para të gatshme (kesh)
TI	Teknologjia Informative
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNODC	United Nations Office on Drugs and Crime

1. HYRJA


Ky vit shënon 10 vjetorin e ndërtimit të bazës legislative sipas standardeve ndërkombëtare të luftes kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjatë vitit 2014, zhvillimi më i rëndësishëm ka të bëjë me miratimin nga ana e Qeverisë Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018.

Procesi i antarësimit të NJIF-K në organizata ndërkombëtare mbetet një nga angazhimet kryesore të njesisë me fokus të veçantë antarësimi në Egmont Group. Ky proces ka hy në fazën finale dhe në njëren nga takimet e ardhshme plenare të këtij institucioni, pritet edhe antarësimi jonë në këtë organizatë të rëndësishme të rrjetit të Njësive të Inteligjencës Financiare në botë. Pjesmarrja e NJIF-K në takimin Plenar të Grupit Egmont është vlerësuar shumë hap pozitiv drejt integritetit dhe rritjes së bashkëpunimit të vendit tonë në nivel ndërkombëtar. Kjo e ka shtyer Njësinë që të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin dhe zgjerimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë. Gjithashtu një ngritje gjithnjë e më e theksuar e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave me agjencitë homologe ndërkombëtare si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojave më të mira në këtë fushë është synim i vazhdueshëm nga ana e NJIF-K.

Pas përfundimit me sukses të Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, janë ndërmarrë hapa të menjëhershëm për vlerësimin e rrezikut sektorial, duke kryer një vlerësim të rrezikut për sektorin e ndërtimit. Ky dokument ka shërbyer si bazë për rishikimin e objektivave dhe aktivitetëve të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 dhe Planit të Veprimit.

Raporti i Progresit i Komisionit European për vitin 2014 vlerëson pozitivisht miratimin e Vlerësimit të rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe mbështetur në këtë edhe krijimin e Strategjisë Kombëtare e cila shërmben si mekanizëm gjithëpërfshirës për menaxhim të rrezikut dhe trajtuar rreziqet e identifikuara. Njëherit ky raport thekson emërimin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik si dhe vlerëson bashkëpunimin operative në mes të institucioneve. Megjithatë ende mbetet sfidë për vendin, statistikat e besueshme për pastrim të parave si dhe të dhënat për dënimet përfundimtare. Në përgjithësi, është bërë një përparim i kufizuar në luftën kundër shpëlarjes së parave, janë vendosur strukturat legislative dhe operative. Megjithatë, rezultatet në këtë fushë duhet të përmirësohen dukshëm. Kosova ende duhet të demonstrojë rezultate të prekshme në luftën kundër krimeve ekonomike dhe financiare.



2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA

2.1. Historiati i NJIF-K

Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës është institucion qendror i pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

Zhvillimet më të rëndësishme vendore në fushën e PPP/PFT

Qendra e Inteligjencës Financiare - FIC

Rregullorja 2004/2 dhe themelimi i FIU Kosovë

- 2004 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) ka nxjerrë Rregulloren 2004/2, me të cilën ka themeluar Qendrën për Inteligjencë Financiare.
- 2004 Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjajshme Penale ka hyrë në fuqi më 1 Mars 2004.
- 2004 Qendra për Inteligjencë Financiare është bërë funksionale në Shtator të vitit 2004 nën menaxhimin e stafit ndërkombëtar të UNMIK-ut.
- 2005 Rregullorja Nr. 2005/9 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjajshme Penale.
- 2006 Rregullorja Nr. 2006/9 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjajshme Penale.
- 2006 Rregullorja Nr. 2006/53 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjajshme Penale.

Bartje e kompetencave nga UNMIK tek EULEX

- 2008 Dorëzimi i kompetencave të QIF nga UNMIK-u tek misioni i EULEX-it.
- 2008 Përdorimi i softuerit goAML.

Njësia e Inteligjencës Financiare - FIU

Ligji 03/L-196 për PPP/PFT

- 2010 Ligji Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit.
- 2010 Krijimi i Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës (NJIF-K) si suksesore e Qendrës për Inteligjencë Financiare të Kosovës.
- 2010 Themelimi i Bordit Menaxhues të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës.
- 2012 Transferimi i kompetencave nga misioni i EULEX-it tek autoritetet vendore.
- 2012 Strategjia për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit
- 2013 Ligji Nr. 04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit.
- 2013 Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- 2014 Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018
- 2014 Vlerësimi mbi pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT) – PECK II

2.2. Detyrat

NJIF-K është themeluar me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizimit (Ligji PPP/PFT)¹. Është institucion qëndror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave. NJIF-K është përgjegjëse për kërkimin, pranimin, analizimin dhe shpërndarjen e informatave tek autoritetet kompetente që kanë mandat hetimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Mandati dhe kompetencat e NJIF-K si dhe obligimet e Subjekteve Raportuese dhe përgjegjësitë e tyre janë të definuara në Ligjin për PPP/PFT.

Kompetencat dhe funksionet e NJIF-K janë siç vijon:

1. Kërkimi, marrja, dhe analizimin i aktiviteteve/transaksioneve të dyshimta (RTD), raporteve të parave në të gatshme (RTG) dhe informatave nga burimet tjera në lidhje me dyshim për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
2. Shpërndarjen e informatave në lidhje me dyshimin për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit tek autoritetet kompetente për hetime të mëtutjeshme;
3. Mbikëqyrja dhe inspektimi i subjekteve raportuese për të siguruar pajtueshmërinë me obligimet e raportimit dhe ruajtjes së shënimeve;
4. Shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi me FIU homologe në juridiksionet tjera dhe me autoritetet tjera të mbikëqyrjes dhe hetimeve;
5. Trajnime për subjektet raportuese dhe autoritetet tjera të hetuesisë dhe personelit të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;
6. Të hartojë statistika dhe raporte dhe pas kësaj t'i bëj rekomandime Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Policisë, Doganave të Kosovës dhe/ose personave apo organeve të tjera, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste; dhe
7. Aplikimi i sanksioneve administrative për mos – pajtueshmëri nga subjektet raportuese.

2.3. Misioni

Misioni i Njesisë për Inteligjencë Financiare është që nëpërmjet mandatit të saj të përcaktuar ligjor, të jetë udhëheqëse në përmirësimin e sistemit të gjithëmbarshtëm vendor në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në nivel kombëtar. Funksionimi i mirëfilltë i këtij sistemi, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitucional dhe aktiviteteve të Njesisë për Inteligjencë Financiare është objektiv kryesor i NJIF-K.

2.4. Vizioni

Vizioni i NJIF-K është që të mirëmbajë pozitën e vet si një ndër njësitë efikase të inteligjencës në Kosovë dhe në rajon, si dhe të arrijë anëtarësimin në organizatat Evropiane dhe ndërkombëtare të kësaj fushe. Qëllimi strategjik i NJIF-K është të sigurojë një regjim efikas për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit në Kosovë duke zhvilluar proceset e veta të brendshme dhe metodat e punës të orientuara kah performanca, korniza ligjore dhe bashkëpunimin me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar.

¹ Ligji Nr. 03/L-196 dhe Ligji Nr. 04/L-178 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, 2010 dhe 2013.



2.5. Buxheti dhe Prokurimi

2.5.1. Buxheti

Bazuar në ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, Bordi Menaxhues i Njësisë, cakton buxhetin e NJIF-K-së sipas propozimit të Drejtorit të njësisë. Drejtori në bashkëpunim me Udhëheqësit e departamenteve, si dhe stafin e buxhetit dhe financave e hartojnë propozimin për buxhetin e NJIF-K. Buxheti përfundimtar përcaktohet në baza vjetore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Plani i Performancës dhe Resurseve të Njësisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017 përcakton edhe planin e buxhetit aktual të NJIF-K si dhe mbulon një periudhë tri (3) vjeçare për periudhën 2015-2017. Aktivitetet në vijim janë planifikuar për implementim:

1. Vazhdim i ndërtimit të kapacitetit të stafit;
2. Vazhdim i ndërtimit të kapacitetit të infrastrukturës së TI-së (pajisje dhe programe);
3. Zhvillimi i kornizës ligjore;
4. Organizimi i trajnimit për subjekte raportuese;
5. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar;
6. Implementimi i vlerësimit të rrezikut kombëtar

Kontrollet e brendshme bazohen në menaxhimin ditor dhe mbikëqyrjen e planit të performancës dhe burimeve. Udhëheqësit e departamenteve menaxhojnë funksionet e veta dhe i raportojnë Drejtorit. Raportet mujore të performancës janë përpiluar për të siguruar transparencën, efikasitetin dhe furnizimin e saktë. Implementimi i objektivave përcillet dhe në bazë të kësaj ndërmerren masa të duhura.

Shënimet të cilat janë të bashkangjitura në vazhdim, përfshijnë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014.

Kategoritë Ekonomike	Buxheti 2014 (ndarja fillestare)	Buxheti pas rishikimit	Buxheti i shpenzuar (realizimi)	Buxheti i shpenzuar %
Paga dhe mëditje	144,161	160,772	160,772	100%
Mallra dhe shërbime	123,589	105,051	102,649	97.71%
Shpenzimet komunale	13,500	11,475	9,695	84.49%
Shpenzime kapitale	70,000	70,000	68,750	98.21%
Gjithsej	351,250	347,298	341,866	98.43%

Tabela nr.1 - Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2014

Buxheti fillestar i NJIF-K ishte miratuar në vlerë prej 351,250 €, ndërsa buxheti final i miratuar pas rishikimit ka qenë 347,298€, duke pësuar shkurtime buxhetore në Kategorinë e Mallrave dhe Sherbimeve dhe Kategorinë e Komunalive në shumë prej 20.563 €, përderisa është bërë rritje në kategorinë e pagave dhe mëditjeve pas rishikimit të buxhetit në shumë prej 16,611€. NJIF-K për periudhën Janar - Dhjetor 2014, ka realizuar buxhetin në vlerë prej 341,866 € ose e shprehur në përqindje 98.43 %. Në kategorinë e Investimeve Kapitale vlera e shpenzuar për këtë kategori ekonomike është 68,842 € ose e shprehur në përqindje 98.21 %.

2.5.2. Aktivitetet e Prokurimit

Gjatë vitit 2014 sipas Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 janë zhvilluar gjithsej dymbëdhjetë (12) aktivitete të prokurimi.

Sipas procedurës aktivitete të prokurimit janë të ndara në :

1. Tre (3) aktivitete të prokurimit kanë qenë me procedurë të hapur,
2. Dy (2) aktivitete kanë qenë vazhdimi të kontratave me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.
3. Tre (3) aktivitete kanë qenë me procedurën e kuotimit të çmimeve dhe
4. Katër (4) aktivitete kanë qenë me procedurën e vlerës minimale.

Ndërsa sipas vlerës se planifikuar të prokurimit

1. Katër (4) janë me vlerë të mesme.
2. Katër (4) janë me vlerë të vogël dhe.
3. Katër (4) janë me vlerë minimale.

2.6. **Organizimi i NJIF-K**

2.6.1. Mbikëqyrja e NJIF-K

Bordi Menaxhues i NJIF-K është i themeluar me ligjin për PPP/PFT përkatësisht nenin 6 të atij ligji i cili bord do të mbikëqyrë dhe sigurojë pavarësinë e NJIF-K-së. Ai nuk ka fuqi ekzekutive ose zbatimi kundrejt NJIF-K-së. Bordi përbëhet nga Ministri i Financave, i cili do të shërbejë në cilësinë e Kryetarit të Bordit. Anëtarë të tjerë të bordit do të jenë, ex officio, Ministri i Punëve të Brendshme, Kryeprokurori i Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtori i Administratës Tatimore, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës, Drejtori Menaxhues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Bordi mban takime së paku dy (2) herë në vit. Bordi nuk ka të drejtë që të ndërhyjë në asnjë mënyrë në çështjet në proces të NJIF-K-së.

2.6.2. Burimet njerëzore dhe Struktura organizative

Drejtori i njësisë, tre (3) zyrtarë administrativ dhe katrëmbdhjetë (14) zyrtarë profesional e përbëjnë strukturën e stafit të NJIF-K. Përveç personelit të saj, NJIF-K ka qenë e mbështetur edhe nga stafi sekondar i përbër nga personeli i Eulex dhe Dogana e Kosovës. Ky staf mbështetës ka dhënë kontribut të frutshëm në njësi duke bartur përvojat dhe njohurit nga vende të ndryshe. Gjithsej pesë (5) zyrtarë sekondar ishin të përfshirë në strukturën e NJIF-K duke arriur numrin e 23 zyrtarëve të angazhaur në NJIF-K.

Personeli i NJIF-it	Numri i Stafit	%
Menaxhmenti	2	11.11%
Departamenti i analizave operacionale	6	33.33%
Departamenti për pajtueshmëri dhe inspektim	4	22.22%
Departamenti i TI	2	11.11%
Departamenti Ligjor dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar	1	5.56%
Departamenti i administratës (Buxheti, Financa & Prokurimi)	3	16.67%
Gjithsej personeli i NJIF-K	18	100.00%

Tabela nr.2 - Struktura e stafit të NJIF-K



NJIF-K ka një (1) zyrtar ndërlidhës nga Dogana e Kosovës për të përmirësuar shkëmbimin e informatave dhe bashkëpunimin operacional. Njësia është pajtuar gjithashtu edhe me Policinë e Kosovës për ndërlidhjen e zyrtarëve sekondar në njësi. Në vitin 2015, një zyrtar nga personeli i Policiës së Kosovës do të filloj punën në njësi.

Stafi Sekondar në NJIF-K	
Stafi ndërkombëtar EULEX-it	Numri i Stafit
Menaxhmenti (Këshilltari EULEX)	1
Analisti i inteligjencës	2
Asistenti administrativ (EULEX)	1
Gjithsej personeli i Eulex	4
Staf ndërlidhës nga Institucionet e zbatimit të ligjit	
Analisti i inteligjencës nga Dogana e Kosovës	1
Gjithsej personeli sekondar	5



Tabela nr.3 – Personeli sekondar i NJIF-K

Që nga viti 2008 stafi ndërkombëtar i Eulex-it ishte pjesë e njësisë, ku vitin e fundit katër (4) përfaqësues të EULEX-it kanë qenë të inkuadruar në NJIF-K. Por në Tetor të vitit 2014, personeli i EULEX ka përfundu misionin e tij në NJIF-K. Kjo nënkupton se kapacitet e NJIF-K janë zvogluar.

Nevojat e NJIF-K për staf të ri janë paraqitur edhe në dokumentin strategjik të saj “Plani i Performancës dhe Resurseve të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017” përmes së cilës planifikohet që njësia të rrisë stafin e tij me gjashtë (6) zyrtarë deri më 31.12.2017. Burimet shtesë do të alokoheshin në funksion të Mbikëqyrjes së Pajtueshmërisë (3), Operacione dhe Analiza (2) dhe Ligjor/Bashkëpunim ndërkombëtar (1).


Stafi i NJIF-K kryesisht përbëhet nga mosha e mesme dhe e re. Rreth 83 % e personelit në njësi përbën moshën nga 18 deri 39 vjet. Personeli i Njif-K është i kualifikuar dhe trajnuar ku rreth 95 % e stafit në njësi posedon përgaditje univeritare të paktën kualifikimin bachelor kryesisht të diplomuar në ekonomi, juridik, shkenca kompjuterike ose inxhinieri elektrike dhe kompjuterike, ndërsa gjinia femrore përfaqsohet me rreth 39 % të të punësuarve në NJIF-K.





Grafiku Nr.1 - Përbërja e stafit të NJIF-K

NJIF-K udhëhiqet nga Drejtori i cili është përgjegjës për drejtimin dhe menaxhimin e njësisë. Struktura Organizative e Njësisë së Inteligjencës Financiare është siç vijon:



3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT

3.1. Zhvillimi i kornizës ligjore

Gjatë vitit 2014, si rezultat i vlerësimit të Projektit kundër Krimin Ekonomik i bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe i implementuar nga Këshilli i Evropës dhe si kërkesë e proceseve të anëtarësimit në Egmont Group, NJIF-K ka ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm me qëllim të harmonizimit të mëtutjeshëm të kornizës Ligjore, dhe me këtë rast Ministria e Financave me datë 05/06/2014 ka nxjerr Vendim Nr. 39/2014 për emërimin e Grupit Punues për Hartimin e Koncept Dokumentit për trajtimin e parandalimin të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Pas përfundimit të hartimit të Koncept Dokumentit të lartcekur, NJIF-K ka përcjellë brenda afateve ligjore dokumentin në fjalë tek Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave për procedim të mëtutjeshëm.

Grupi Punues për hartimit e Koncept Dokumentit ka identifikuar se ligji në fuqi ka probleme përmbajtësore dhe teknike, të cilat vështirësojnë implementimin, andaj edhe duhet rishikuar.

Në aspektin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, është konstatuar se Ligji është në masën më të madhe në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF), të cilat janë ri-shikuar në vitin 2012. Mirëpo, janë identifikuar mangësitë e caktuara në këtë drejtim, e veçanërisht ato përkitazi me parandalimin e financimit të terrorizmit dhe mekanizmat raportues, që duhet të adresohen.

3.2. Aktet nënligjore

3.2.1. Udhëzimet Administrative

Njësia për Inteligjencë Financiare gjatë vitit 2014 me qëllim të sigurimit dhe promovimit të pajtueshmërisë me Ligjin Nr. 03/L-196 të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178 ka nxjerr aktet nënligjore që kanë të bëjnë me kujdesin e duhur dhe të shtuar ndaj klientit nga ana e subjekteve raportuese si dhe procedura të brendshme që kanë të bëjnë me procesin e punës operative dhe inspektimit të pajtueshmërisë.

- Udhëzim Administrativ i Njesisë për Inteligjencë Financiare Nr. 02/2014 Mbi përjashtimin e transaksioneve të caktuara nga raportimi
- Udhëzim Administrativ i Njesisë për Inteligjencë Financiare Nr. 03/2014 për Procedurat e shqiptimit të sanksioneve administrative ndaj subjekteve raportuese që nuk janë në pajtueshmëri me LPP/PFT
- Udhëzim Administrativ i Njesisë për Inteligjencë Financiare Nr. 04/2014 Personat e Ekspozuar Politikisht
- Udhëzimi Administrativ NJIF-K nr. 05/2014 mbi standardet minimale, procedurat e shkruara dhe kontrollet për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga profesionistët në fjalë.



3.2.2. Procedurat Standarde të Veprimit

Gjithashtu, gjatë vitit 2014, NJIF-K me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit reciprok me institucionet dhe organet e tjera në Kosovë, si dhe në mënyrë që të ndihmojnë njëra-tjetrën gjatë kryerjes së detyrave të tyre dhe koordinimit të aktiviteteve kanë nxjerrë procedura standarde sa i përket bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit.

- Procedurat Standarde të Operimit për Mbikëqyrjen e Pajtushmërisë

PSO Aneks 1 - Matrica mbi obligimet

PSO Aneks 2 - Programi vjetor për mbikëqyrjen e pajtushmërisë

PSO Aneks 3 – Kontroll / Lista për vizitën për inspektimin në terren

PSO Aneks 4 - Gjetjet kryesore mbikëqyrëse


PSO Aneks 5 - Shkeljet që bëjnë pjesë në procesin e sanksionimit

- Procedura Standarde Operative për goAML bazuar në Proceset e Punës
- Manuali i Përdoruesit për formularët goAML
- goAML Web Manuali për Përdorues për Subjektet Raportuese
- Procedura Standarde e Operimit lidhur me kërkesat automatike të informatave nga NJIF-K dhe Policia e Kosovës

Aneksi 1 - Skriptet (shënimet), komandat dhe procedurat e NJIF-K

Aneksi 2 - Skriptet (shënimet), komandat dhe procedurat e Sistemit të Policisë së Kosovës

- Procedurat Standarde të veprimit për shkëmbimin e informatave NJIF-K dhe ATK
- Procedurat Standarde Operative për shkëmbim të informatave mes NJIF-K dhe ARC




4. PERFORMANCA E NJIF KOSOVË

4.1. Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare

NJIF-K është e autorizuar të pranojë, procedojë, të marrë dhe analizojë raportet dhe informacionet e obliguesve të ligjit, që i janë ofruar NJIF-K nga NJIF-të e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, nga gjykatat ose nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare e ndërkombëtare, organet publike ose qeveritare si dhe që i janë ofruar vullnetarisht NJIF-K në lidhje me dyshimet për shpërlarjen e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste.

NJIF-K mund të bëjë publikimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe dokumenteve zyrtare për autoritetet kryesore hetuese të zbatimit të ligjit në Kosovë, një organ publik ose qeveritar të Republikës së Kosovës nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente NJIF-K si dhe në organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ato organe që kryejnë funksion të ngjashëm me NJIF-K-në, jashtë Kosovës, nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente ose do t'i ndihmonte NJIF-K që të kryejë funksionet e saj.

Të gjitha të dhënat, informacionet dhe dokumentet zyrtare bëhen publike nga NJIF-K-ja vetëm për qëllime inteligjence, me qëllim të ofrimit të bazës për hetime.




4.1.1. Të dhënat dhe raportet e procesuara

Gjatë këtij viti raportuese janë krijuar format e reja të menaxhimit të raporteve. Llojet kryesore të raporteve të të dhënave të cilat janë të ngarkuara në sistemin goAML janë:

1. Raportet e informative shtesë (AIF)
2. Raportet e transaksioneve në para të gatshme (CTR),
3. Kërkesat e OJQ-ve për përjashtim nga raportimi (ER),
4. Raportet për pezullimin e transaksioneve (FRZ),
5. Raportet e Inspektimit të Pajtueshmërisë (INR),
6. Kërkesat vendore për Informata të pranura (IRD),
7. Kërkesat ndërkombëtare për informata të pranura (IRI),
8. Kërkesat e NJIF-K për autoritetet vendore (ORD),
9. Kërkesat e NJIF-K drejtuar NJIF-ve ndërkombëtare (ORI),
10. Raportet e transaksioneve të dyshimta (STR),
11. Raportet e transaksioneve të dyshimta për financim të terrorizmit (TFR) dhe
12. Raportet e transaksioneve të pazakonshme (UTR)

Të gjitha këto raporte mund të integrohen në sistem, qoftë përmes formës dhe mënyrës online të raportimit duke ngarkuar XML raportin, qoftë përmes formës manuale. Në vitin 2014 në sistemin elektronik të NJIF-K janë procesuar gjithsej 10,607 raporte:



Grafiku Nr.2 – Numri i raporteve të procesuara përmes sistemit elektronik dhe online 2014




4.1.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit kërkon që subjektet raportuese të raportojnë të gjitha aktet ose transaksionet e dyshimta brenda një periudhe kohore, varësisht nga sektori apo subjekti raportues, nga koha kur akti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë. Akti ose Transaksioni i Dyshimtë nënkupton një akt ose transaksion, ose një akt ose transaksion i tentuar, që gjeneron një dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është produkt i krimit dhe do të interpretohet në përputhje me çdo udhëzim të lëshuar nga NJIF-ja për aktet apo transaksionet e dyshimta.

Midis viteve 2011 dhe 2014, numri i RTD-ve të raportuara është dyfishuar nga 135 në 295. Kjo rritje e numrit të RTD-ve të pranura tregon për një zhvillim pozitiv. Kjo pasqyron vigjilencën në ngritje të subjekteve raportuese dhe një nivel më të lartë të vetëdijes së PPP/LFT. Krahas rritjes kuantitative të raportimeve të dyshimta, NJIF-K është e orientuar edhe në rritje kualitative të raportimeve të transaksioneve të dyshimta, kjo qoftë përmes mbajtjes së takimeve dhe trajnimeve të rregullta me subjektet raportuese, ose edhe përmes aplikimit të kthimit të informatave kthyesë.

Grafiku Nr.3-Numri i RTD-ve të raportuara



	2011	2012	2013	2014
RTD-të e pranura	135	202	174	295


Tabela nr.4 - Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2014

Sektori bankar vazhdon të jetë burimi kryesor i RTD-ve edhe në vitin 2014, edhe pse një rritje në numrin e RTD-ve është vërejtur dukshëm se rrjedhë nga sektorë të tjerë duke potencuar këtu Agjensionet për Transfer Parash. Përveç kësaj nga ky vit vërehet një gadishmëri e disa prej subjekteve tjera raportuese për përmbushjen e obligimeve të tyre ligjore në lidhje me detyrimet e tyre për raportim. Një ndarje e RTD-ve të raportuara nga sektorë të ndryshëm është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.




Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve				
Subjektet Raportuese	2011	2012	2013	2014
Bankat	129	196	165	234
Kompanitë e Sigurimeve	0	0	0	0
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	0	0	0	1
Agjensionet për Transfer Parash	3	6	6	58
Kazinot	0	0	0	0
Agjentët e patundshmërive	0	0	0	0
Tregtarët me metale/gurë të çmuar	0	0	0	0
Avokatët	0	0	0	0
Noterët	0	0	1	0
Kontabilistët e çertifikuar dhe këshilltarët tatimor	0	0	0	0
Auditorët e licencuar	0	0	0	0
Ofruesit e shërbimeve të trustit dhe kompanive	0	0	0	0
Profesionistët e tjerë	0	0	0	0
Dogana e Kosoves	3	0	1	1
Tjera	0	0	1	1
Gjithsej	135	202	174	295

Tabela nr.5- Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2011-2014




Grafiku Nr.4- Numri i RTD-ve të raportuara në 2014 sipas sektorëve

Edhe këtë vit disa nga subjektet tjera raportuese vazhdojnë të jenë të përfaqësuara në numër jashtëzakonisht të vogël në dërgimin e raporteve. Këtu vlen të theksohen subjektet siç kërkohet për të raportuar në pajtim me nenet 24-28 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë këtu avokatët, kontabilistët dhe auditorët, kazinot dhe lojrat e fatit, partitë politike, kompanitë e ndërtimit etj. Kjo njëherit tregon që ka një vullnet shumë të ulët të përpjekjeve të tyre për të qenë në harmoni me ligjin.



Grafiku Nr.5- RTD të raportuara në vitet 2013 dhe 2014 sipas sektorëve




Grafiku Nr.6 - RTD e pranuar për Pastrim të parave dhe financim të terrorizmit 2014



Informacionet statistikore mbi raportet e dyshimta (RTD) të pranuar nga NJIF-K				
Subjekti raportues	2013		2014	
	Raporet në lidhje me transaksionet e dyshimta		Raporet në lidhje me transaksionet e dyshimta	
	PP	FT	PP	FT
Bankat dhe Institucionet Financiare				
Bankat	159	6	219	15
Kompanitë e Sigurimeve	0	0	0	0
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	0	0	1	0
Agjensionet për Transfer Parash	6	0	57	1
Gjithsej Bankat dhe Institucionet Financiare	165	6	276	16
BPPJF-të				
Kazinot	0	0	0	0
Agjentët e patundshëmive	0	0	0	0
Tregtarët me metale/gurë të çmuar	0	0	0	0
Avokatët	0	0	0	0
Noterët	1	0	0	0
Kontabilistët e çertifikuar dhe këshilltarët tatimor	0	0	0	0
Auditorët e licencuar	0	0	0	0
Ofruesit e shërbimeve të trustit dhe kompanive	0	0	0	0
Profesionistët e tjerë	0	0	0	0
Gjithsej BPPJF-të	1	0	0	0
ENTITETET TJERA RAPORTUESE				
Dogana e Kosoves	0	1	1	0
Tjera	1	0	1	0
Gjithsej Entitetet tjera Raportuese	1	1	2	0
Totali	167	7	279	16
Gjithsejt RTD e pranuar për PP/FT	174		295	

Tabela nr.6 - Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për PP dhe FT të pranuar nga Njif 2013-2014



4.1.3. Raportet e transaksioneve të dyshimta për Financim të Terrorizmit

Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta për financim të terrorizmit ka shënuar ngritje në vitin 2014 krahasuar me një vit më herët. Gjithsej 16 raporte të aktivitetit të dyshimtë për financim të terrorizmit janë pranuar në NJIF-K gjatë vitit 2014. Pjesa më e madhe e këtyre raporteve janë raportuar nga institucionet financiare duke përfshirë bankat dhe agjensionet për transfer të parave. Numri i personave të përfshirë në këto raporte ka qenë gjithsej 56 persona fizikë dhe subjekte juridike.

NJIF-K pas analizimit, përpunimit dhe grumbullimit të informacioneve tjera ka shpërndarë raporte të inteligjencës tek institucionet tjera kompetente të zbatimit të ligjit për hetime të mëtutjeshme.


4.1.4. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)

Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit i obligon subjektet raportuese të raportojnë të gjitha transaksionet individuale në para të gatshme (RTG) në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose më shumë. Transaksionet e shumëfishta do të trajtohen si një transaksion individual nëse banka apo institucioni financiar është në dijeni se transaksionet janë nga apo në emër të një personi ose subjekti dhe kapin vlerën prej më shumë se dhjetëmijë (10.000) Euro në një (1) ditë të vetme.

	2011	2012	2013	2014
RTG të pranuar	423,443	480,479	606,778	553,651

Tabela nr.7 - RTG të raportuara për periudhën 2011-2014

Në mes viteve 2011 dhe 2014, numri i RTD-ve ka pësuar disa ndryshime. Në vitin 2014 numri i këtyre raporteve të transaksioneve në para të gatshme ka shënuar një rënje. Kjo rënie e numrit të raporteve ka mundur të vije si rezultat i lëshimit të Udhezim Administrativ të Njësisë për Inteligjence Financiare nr. 02/2014 mbi përjashtimin e transaksioneve të caktuara nga raportimi i cili kërkon lirim të personave ose subjekteve, apo grup personash ose subjektesh, nga obligimet e raportimit sipas atij ligji, si dhe metodat për të raportuar lirime të tilla.



Grafiku Nr.7 - RTG të pranuar

Numrin më të madhë të raporteve të dërguara e përbëjnë bankat dhe institucionet financiare, përdërisa një numër të përafërt të raporteve krahasuar me vitin 2013 e ka dërguar edhe Dogana e Kosovës.

Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) të pranuar				
	2013		2014	
Subjekti raportues	Numri i Raporteve të pranura	Numri i Transaksioneve	Numri i Raporteve të pranura	Numri i Transaksioneve
Institucionet Financiare				
Bankat dhe Institucionet Microfinanciare	1,563	601,208	1,712	548,176
Sektori i Sigurimeve	0	0	3	11
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	241	2,531	297	2,959
Agjensionet për Transfer Parash	21	1,111	25	500
Gjithsej Institucionet Financiare	1,825	604,850	2,037	551,646
Entitetet tjera Raportuese				
Dogana e Kosoves	12	1,928	12	2,005
Gjithsej Entitetet tjera Raportuese	12	1,928	12	2,005
Gjithsej RTD e pranuar	1,837	606,778	2,049	553,651

Tabela nr.8- Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) sipas sektorëve

Në tabelën më poshtë janë prezantuar transaksionet e raportuara² në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose më shumë si dhe transaksionet e ndërlidhura në emër të një personi ose subjekti dhe që kapin vlerën prej më shumë se dhjetëmijë (10.000) Euro në një (1) ditë të vetme, që nënkupton transaksionet e kryera nën pragun e raportimit apo ato transaksione të shumëfishta të kryera në emër të një personi ose subjekti:

Vlerat	Nr. i transaksioneve	Lloji i Raportit
0 - 9,999 €	380,228	RTG
10,000 - 49,999 €	151,878	RTG
50,000 - 99,999 €	7,603	RTG
100,000 - 499,999 €	1,604	RTG
500,000 - 999,999 €	6	RTG
mbi 1,000,000 €	3	RTG

Tabela nr.9- Transaksionet e raportuara përmes sistemit online të raportimit

² Transaksionet e raportuara vetëm përmes sistemit online të raportimit në goAML



4.1.5. Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme (Monitorimi special i transaksioneve të veçanta)

Subjektet raportuese duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve të ndërlikuara dhe jashtëzakonisht të mëdha të cilat nuk kanë qëllime të qarta ekonomike ose ligjore.

Subjektet raportuese duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve afariste dhe transaksioneve me personat, duke përfshirë personat juridik dhe marrëveshjet ligjore nga ose në vende që nuk i aplikojnë ose i aplikojnë në mënyrë të pamjaftueshme, standardet ndërkombëtare përkatëse për të luftuar shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.

Subjektet raportuese duhet të paraqesin me shkrim informacionin specifik në lidhje me transaksionet e referuara më lartë, si dhe të identifikojnë të gjitha palët e përfshira. Raporti duhet të ruhet dhe një gjë e tillë duhet të vihet në dispozicion të NJIF-K.

Kërkesat e lartëpërmendura kërkohen me nenin 20 të ligjit për PPP/PFT, me anë të së cilit kërkohet nga subjektet raportuese monitorimi special i transaksioneve të veçanta. Tri transaksione janë raportuar si jo të zakonshme:

	2011	2012	2013	2014
UTR-të e pranuar	0	0	€ 419,436.24	€ 1,001,320.00

Tabela nr.10- Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme

4.1.6. Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës

Secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë duhet të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre. I njejtë detyrim vlenë edhe për secilin person qoftë ai juridik ose fizikë i cili nga Kosova dërgon mjete jashtë vendit. Kjo kërkesë ligjore është e rregulluar me nenin 29 të ligjit për PPP/PFT.

Implementimin e kësaj dispozite ligjore e zbaton Dogana e Kosovës. Kjo e fundit vitin e kaluar ka raportuar në NJIF-K gjithsej 2,005 transaksione në para të gatshme, ku nga Personat Juridikë janë deklaruar 1,411 transaksione, përderisa Personat Fizikë kanë deklaruar në 594 transaksione në para të gatshme. Vlerat monetare të këtyre transaksioneve sipas valutave janë paraqitur si në vijim:



Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare			
Valuta	Vlera monetare e RTG-ve		Vlera totale e pranimit të RTG-ve
	Personat Juridik	Personat Fizik	
1	2	3	4 = (2+3)
ALL (Lek)	15,050,000.00	400,000.00	15,450,000.00
AUD	388,475.00	-	388,475.00
CAD	704,860.00	-	704,860.00
CHF	504,365,100.00	6,730,060.00	511,095,160.00
DIN	8,625,212,360.00	-	8,625,212,360.00
DKK	1,557,930.00	-	1,557,930.00
EUR	647,950,678.00	10,156,619.00	658,107,296.58
GBP	14,218,800.00	9,800.00	14,228,600.00
HRK	683,245.00	-	683,245.00
NOK	51,635,350.00	38,000.00	51,673,350.00
RUB	91,510.00	-	91,510.00
SEK	18,747,980.00	-	18,747,980.00
USD	44,841,077.00	387,055.00	45,228,132.00

Tabela nr.11 - Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës

Përveç deklartimit të mjeteve monetare, NJIF-K gjithashtu pranon raporte të mosdeklarimit të mjeteve monetare, ku me këtë rast Dogana e Kosovës shqipton gjobë prej 25 % të shumës së mjeteve monetare të padeklaruara në posedim të tij/saj për të cilat ka detyrim për të deklaruar. Në vitin 2014, numri i gjobave të shqiptuara për mosdeklarim ka qenë në gjithsej 19 raste.

4.1.7. Ngrirja e transaksioneve bankare


NJIF-K-ja mund të udhëzojë bankën apo institucionin financiar që të pezullojë ndërmarrjen e veprimit lidhur me aktin ose transaksionin e dyshimtë për një kohë maksimale prej dyzetetë (48) orëve ose dy (2) ditë pune, varësisht se cila periudhë është më e gjatë. Numri i udhëzimeve të lëshuara për ngrirje të llogarisë ka qenë njëzet (20), përderisa vlera monetare e transaksioneve të ngrira ka arritur deri në rreth 774,115 €. Krahasuar me vitet e kaluara ky është numri më i madhë i transaksioneve të ngrira nga ana e NJIF-K.

2014	
Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit	
Numri i udhëzimeve të lëshuara për pezullim të transaksionit	20
Numri i transaksioneve/llogarive të ngrira	136
Shuma (EUR)	774,115.00 €

Tabela nr.12 - Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit

4.1.8. Sistemi Elektronik i pranimit të RTD-ve dhe RTG-ve

Sistemi Online i pranimit të raportve është platformë online që mundëson subjekteve raportuese të raportojnë përmes sistemit elektronik të përpunimit të të dhënave nëpërmes sistemit të sigurt për ruajtjen e të dhënave. Deri në fund të vitit 2014, rreth 27,468 raporte janë procesuar nga përdoruesit e sistemit online të raportimit, përderisa mbi 15,000 komunikime elektronike janë zhvilluar gjatë vitit 2014. Rreth 176 përdorues nga subjektet raportuese dhe institucionet publike janë të regjistruar për raportimin dhe shkëmbim të informacioneve online me NJIF-K.



Grafiku Nr.8 - Sistemi Elektronik i pranimit të RTD-ve dhe RTG-ve

4.1.9. Kërkesat e OJQ-ve për përjashtim nga ndalesat ligjore

Ligji Nr. 03L-196 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178 në nenin 24 përcakton detyrime shtesë për OJQ-ve.

Konkretisht, paragrafi 1 i Nenit 24 përcakton që OJQ-ja nuk mund të pranojë kontribute në para që tejkalojnë një mijë (1,000) Euro nga një burim i vetëm brenda një (1) dite të vetme si dhe paragrafi 2 i Nenit 24 përcakton që OJQ-ja nuk mund të paguajë para që tejkalojnë pesë mijë (5,000) Euro brenda një (1) dite të vetme cilitdo marrësi të vetëm.

Paragrafi 3 i Nenit 24 të ligjit në fuqi mundëson që për të qenë në gjendje që të bëjnë ose pranojnë pagesa që i tejkalojnë shumat e cekura më sipër, OJQ-ja mund të kërkojë nga NJIF-K lirimin e njëhershëm ose të vazhdueshëm nga këto ndalesa. Kërkesa me shkrim që dorëzohet nga OJQ tek NJIF-K duhet të potencojë llojin e kërkuar të lirimit dhe arsyet për këtë lirim, ndërsa NJIF-K duhet t'i përgjigjet kësaj kërkesë brenda 30 ditësh. Përgjigjet e NJIF-K mund të jenë: 1) lejohet; 2) lejohet me kusht; 3) refuzohet lirimi. Kërkesa drejtuar NJIF-K është mënyra e përcaktuar ligjore për t'u përjashtuar nga kufizimet e neneve 24.1 dhe 24.2.

Gjatë vitit 2014 NJIF-K ka pranuar dhe proceduar 16 kërkesa nga OJQ-të për lirim nga ndalesat ligjore të përcaktuara në nenin 24 të Ligjit në fuqi për PPP/PFT.

2014				
Kërkesat e OJQ-ve për lirim nga paragrafi (1) dhe (2) i nenit (24)	Përgjigjet e NJIF-K			
	Të liruara	Të Liruara me kusht	Të Refuzuara	Gjithsej
Kërkesë e Njëherëshme	2	3	2	7
Kërkesë e Vazhdueshme	5	3	1	9
Gjithsej Kërkesat e shqyrtuara nga NJIF-K	7	6	3	16

Tabela nr.13 - Kërkesat e OJQ-ve për lirim të njëhershëm apo të vazhdueshëm

4.2. **Analizimi dhe Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek autoritetet kombëtare dhe homologët ndërkombëtar**

4.2.1. Analizimi i raporteve të inteligjencës

Në vitin 2014, NJIF-K ka hapur gjithsej 276 raste nën dyshimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo veprave tjera të ndërlidhura. Rreth 94 % e këtyre rasteve të hapura kanë rrejdhur nga raportet e aktiviteteve të dyshimta të pranuar në NJIF-K dhe të raportuara kryesisht nga subjektet e obliguara të raportojnë si dhe nga kërkesat për informata dhe bashkëpunimit ndër-agjensi.

Rastet e Hapura	2014
Rastete e hapura bazuar në RTD	77
Rastet e hapura nga NJIF-K (informacioni anonim)	14
Rastete e hapura nga Informatat Spontane nga FIU tjera	1
Kerkesat për informata	182
Projektet e përbashkëta të analizave/hetimeve me Institucionet tjera të zbatimit të ligjit	2
Gjithsej Rastet e Hapura	276

Tabela Nr.14 - Rastet e Hapura 2014


4.2.2. Hapja e rasteve me iniciativë të NJIF-K

Progres i theksuar në këtë fushë është shënuar këtë vit, kjo si rezultat i angazhimeve shtesë të departamentit të analizave dhe operacioneve në identifikimin dhe analizimin e raporteve të kesh-it, si dhe publikimive të ndryshme të bëra në media dhe mjetet e informimit. Gjithsej 52 raste janë propozuar me iniciativë të NJIF-K e cila përbën rreth 19% të rasteve të hapura (276) gjatë vitit 2014.



Propozim për hapje të rasteve	2014	%
Propozim për hapje të rasteve bazuar në analizimin e RTG-ve	40	76.92%
Informacioni i marrur nga Institucionet Publike	2	3.85%
Propozim për hapje të rasteve bazuar në informacionet e marruara nga mediat	2	3.85%
Informacioni spontan i derguar nga NJIF ndërkombëtare	1	1.92%
Informacioni i ofruar vullnetarisht NJIF-K-së në lidhje me dyshimet për shpërlarjen e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste	7	13.46%
Gjithsej	52	100.00%

Tabela Nr.15 - Rastet e iniciuara dhe propozuara me initiative të NJIF-K sipas burimit 2014



Qasja proaktive e Njesisë për Inteligjencë Financiare ka shënuar progres në vitin 2014. Kjo ka ardhur si rezultat i analizimit më të thellë të raporteve në para të gatshme, për të cilën njësia ka krijuar edhe Procedura Standarde të Operimit për kontrollimin, analizimin dhe përpunimin e të dhënave për trajtimin e këtyre rasteve. Ky vit, krahasuar me periudhat e kaluara, ka shënuar ngritje të theksuar të rasteve të propozuara me iniciativë të vet.

Propozim për hapje të rasteve me iniciativë të NJIF-K	2011	2012	2013	2014
Rastet e Propozuara	6	5	0	52

Tabela nr.16 – Rastet e hapura me initiative të NJIF-K 2011-2014

Grafiku Nr.9 – Rastet e propozuara

4.2.3. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek institucionet vendore dhe homologët ndërkombëtar

Me qëllim të përmbushjes së mandatit të saj ligjor, NJIF-K pas përpunimit dhe analizimit të raporteve dhe informacioneve të raportuara nga të detyruarit ligjërish, që i janë ofruar njësisë nga NJIF-të e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, që i janë ofruar vullnetarisht njësisë, të dhënat e grumbulluara dhe që është në dispozicion publik dhe që kanë lidhje me shpërlarjen e parave ose financimin e aktiviteteve terroriste si dhe pas kërkesave për informacion shtesë nga të detyruarit, NJIF-K publikon dhe shpërndanë informacione dhe raporte të inteligjencës për institucionet e zbtimit të ligjit në vend ose për organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ato organe jashtë Kosovës që kryejnë funksion të ngjashëm me NJIF-K.

Përkundër rritjes së numrit të transaksioneve të dyshimta të raportuara gjatë vitit 2014, ky vit ka shënuar rënien e numrit të raporteve të shpërndara të lidhura me RTD. Kjo rënie e numrit të raporteve të shpërndara ka ardhur jo për shkak të mungesës së transaksioneve të mundshme të dyshimta, por më tepër për mungesën e kapaciteteve brenda NJIF-K, ku gjatë atij vitit ka

pasur zvogëlim të numrit të stafit profesional në njësi, kjo për shkak të përfundimit të mandatit dhe largimit nga NJIF-K të stafit të Eulex, i cili njëherit ka shkaktuar zvogëlim të kapaciteteve të NJIF-K. Në këtë rënie ka ndikuar edhe inspektimet e pajtueshmërisë të ndërmarra gjatë vitit 2014, rreth 50 % e kapaciteteve të njësisë ka qenë e përqendruar në ato inspektime, kjo për shkak të mungesës së inspektimeve në teren gjatë periudhës 2010-2013. Edhe pse ky vit ka shënuar rënie me vitin paraprak, përderisa krahasuar me dy vitet e mëparshme, numri i raporteve të inteligjencës të krijuar si rezultat i raporteve të dyshimta, ka pasur ngritje të raporteve të shpërndara tek autoritetet e ndjekjes penale, nga 40 përkatësisht 45 raporte të shpërndara në vitet 2011 dhe 2012, ky numer ka shkuar në 59 në vitin 2014.


	2011	2012	2013	2014
Raportet e shpërndara të inteligjencës	40	45	74	59

Tabela Nr.17 - Raportet e inteligjencës të shpërndara 2011-2014

Në 2014, shumica e raporteve të inteligjencës financiare janë dërguar për hetim të mëtutjeshëm tek njësitë përkatëse në Policinë e Kosovës. Pjesa më e madhe e raporteve apo rreth 88% janë shpërndarë nën dyshimin e pastrimit të parave apo veprave të ndërlidhura penale, ndërsa 7 raporte janë dërguar mbi bazën e dyshimit për financim të terrorizmit. Shpërdarja e këtyre raporteve tek agjencitë tjera vendore të zbatimit të ligjit është paraqitur në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

	Viti 2013	%	2014	%
Policia e Kosovës	44	59.46%	27	45.76%
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	0	0.00%	1	1.69%
Administrata Tatimore e Kosovës	21	28.38%	21	35.59%
Dogana e Kosovës	4	5.41%	2	3.39%
EULEX	2	2.70%	2	3.39%
Fiu ndërkombëtare	3	4.05%	6	10.17%
Gjithsej Rastet e Shpërndara	74	100%	59	100%

Tabela Nr.18 - Raportet e inteligjencës të shpërndara referuar në institucione përkatëse 2013-2014



Grafiku Nr.10 - Raportet e inteligjencës të shpërndara në vitin 2014

4.2.4. Kërkesat për informata nga institucionet vendore dhe homologët ndërkombëtar

Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit e obligon NJIF-K dhe institucionet dhe organet tjera në Kosovë të bashkëpunojnë në mënyrë reciproke, të ndihmojnë njëra tjetrën gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe t'i koordinojnë aktivitetet në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme. Ky bashkëpunim ndër-institucional ka shënuar ngritje nga viti në vit, ku përveç shpërndarjes së raporteve të dërguara për hetim të mëtutjeshëm të rrjedhura nga raportet e transaksioneve të dyshimta, një pjesë e konsiderueshme e kapaciteteve të NJIF-K ka qenë e përqendruar edhe në pranimin dhe kthimin e përgjigjeve bazuar në kërkesat për informata dhe bashkëpunimin mes institucioneve të zbatimit të ligjit dhe ndihmen e ofruar me qëllim të zbulimit të hetimeve. Kjo ngritje e bashkëpunimit ka rrjedhur si rezultat i ngritjes së vetëdijes për ndërlidhjen e veprave penale, si dhe funksionet dhe roli i NJIF-K është bërë edhe më tepër i njohur në vend.

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre autoritetet kompetente mund të hasin në veprat penale të cilat mund të jenë të ndërlidhura qoftë me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, dhe ato falë bashkëpunimit tonë e njoftojnë NJIF-K për dyshimet e ngritura duke parashtruar kërkesë për informata. Në përputhje me rrethanat, njësia mund të fillojë me përpunimin analitik të transaksioneve ose aktiviteteve të dyshimta, ose edhe mund ta refuzoj kërkesën e tillë nëse vëren se rasti nuk ka të bëjë me elementet e dyshimit për PP/FT ose veprave të ndërlidhura penale. NJIF-K gjatë vitit 2014, ka pranuar gjithsej 196 kërkesa, ku numrin më të madh të këtyre kërkesave (rreth 46%) i kishte parashtruar Policia e Kosovës, pastaj Prokuroria, Dogana e Kosovës, Eulex, Administrata Tatimore, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë etj.

Rritje të numrit të kërkesave ka pasur gjithashtu edhe nga NJIF e huaj, ku bazuar në ligjin për PPP/PFT, NJIF-K është në gjendje për të shkëmbyer ndërkombëtarisht të gjitha informatat që mund të jenë të arritshme apo të mundura direkt ose indirekt nga NJIF-K. Informacioni mund të bëhet publik për organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ato organe që kryejnë funksion të ngjashëm me NJIF-K-në, jashtë Kosovës, nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente ose do të ndihmonte NJIF-K që të kryejë funksionet e saj. Nga 7 kërkesa të drejtuara nga NJIF e huaj për NJIF Kosovë në vitin 2013, ky numer ka arritur në 19 gjatë vitit 2014. Detajet më të hollësishme për bashkëpunimin ndërkombëtar mund të gjenden tek kapitulli "Bashkëpunimi me homologët e huaj". Në tabelën në vijim janë paraqitur kërkesat për informata nga autoritetet vendore dhe ndërkombëtare:

	2011	2012	2013	2014
Numri i kërkesave për informata të pranuar nga autoritetet vendore	64	103	183	177
Numri i kërkesave për informata të pranuar nga FIU homologe të huaja	10	10	7	19
Gjithsej kërkesat për informata të pranuar në NJIF-K	74	113	190	196


Tabela Nr.19 - Kërkesat për informata të pranuar në NJIF-K 2011-2014



Pas pranimit dhe procesimit të informatave të tilla dhe pasi të dhënat janë kompletuar apo analizuar nga ana e NJIF-K, bëhet shpërndarja e raporteve të inteligjencës varësisht nga dyshimi i ngritur për pastrim të parave, financim të terrorizmit ose veprave penale të ndërlidhura.

	2011	2012	2013	2014
Numri i kërkesave për informata të shpërndara tek autoritetet vendore	71	104	174	174
Numri i kërkesave për informata të shpërndara tek FIU homologe të huaja	11	13	5	20
Gjithsej kërkesat për informata të shpërndara nga NJIF-K	82	117	179	194

Tabela Nr.20 - Kërkesat për informata të shpërndara nga NJIF-K 2011-2014



Grafiku Nr.11 - Kërkesat për informata të pranuar dhe shpërndara nga NJIF-K

Me qëllim të fuqizimit edhe më shumë të bashkëpunimit ndër-institucional, në fund të vitit 2014, janë krijuar mekanizma të përbashkët për shkëmbimin e informacioneve në mes të agjencioneve të cilat kanë përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e krimeve financiare. Për këtë qëllim është nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Prokurorisë së Shtetit, Policisë së Kosovës, Dogananës, Administratës Tatimore dhe NJIF-K, për shkëmbim të informatave, vlerësim të rrishtit dhe koordinim në mes të institucioneve dhe agjencioneve të zbatimit të ligjit. Kjo marrëveshje është në harmoni dhe pjesë komplementare e zbatimit të strategjive nacionale në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimeve financiare.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi NJIF-K ka proceduar raste varësisht nga dyshimet e ngritura, ku bazuar në kërkesat e lartpërmendura numri i personave të përfshirë ka qenë rreth 1,232 persona dhe rreth 63 subjekte juridike, ndërsa disa nga veprat kryesore penale të ndërlidhura me PP/FT kanë qenë si në vijim:

- Keqpërdorim i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar,
- Përfshirje në dyshimin për Pastrim i Parasë,
- Përfshirje në dyshimin për Financim të Terrorizmit,
- Përfshirje në dyshimin për Pastrim të Parave dhe shitblerje/Trafikim të Lendëve narkotike,
- Përfshirje në dyshimin për Pastrim i Parasë, dhënie dhe marrje rryshfeti, ndihmë në kryerjen e veprës penale,
- Dyshimi për tregti të pandershme – Mashtrim,
- Përfshirje në dyshimin për Pastrim i Parasë, Trafikim i qenieve njerëzore,
- Evazion Fiskal,
- Krim i organizuar ,
- Kontrabandim me migrantë,
- Blerje, posedim, shpendarje dhe shitje e pa autorizuar e narkotikëve, substanca psikotropike dhe analoge,
- Dyshim për përfitim joproporcional
- Kontrabandim i mallit dhe krime të tjera
- Korrupsion
- Kontrabandim i armëve
- Vjedhje e rënde
- Kontrabandim me mallra, shmangie të pagesave doganore, tregti e ndaluar.

4.3. Inspektimi i pajtueshmërisë

Pas plotësimit ndryshimit të ligjit Nr. 03/L-196 me Ligjin Nr. 04/L-178, NJIF-K i është dhënë mandatin për ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë dhe inspektimit të subjekteve raportuese.

Me këtë rast me qëllim të ushtrimit të kësaj kompetence NJIF-K ka hartuar Procedurën Standarde të Operimit për Mbikëqyrjen e Pajtueshmërisë e cila ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2014, e cila parasheh procedurat standarde të inspektimit të pajtueshmërisë siç përcaktohet në nenin 30 të Ligjit në fuqi.

Në përputhje me kapitullin 4 të Procedurës Standarde të Operimit për Mbikëqyrjen e Pajtueshmërisë, NJIF-K ka hartuar dhe aprovuar planin vjetor për inspektimet e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese për vitin 2014. Hartimi i planit vjetor të inspektimit është bërë sipas një vlerësimi të përgjithshëm të rrezikut që paraqesin kategoritë e caktuara të subjekteve raportuese në fushën e pastrimit të parave dhe financimit e terrorizmit.

Bazuar në PSO për Mbikëqyrjen e Pajtueshmërisë NJIF-K mund të realizoj inspektimet si në vijim:

- Inspektimi në teren
- Inspektimi nga zyra
- Inspektimi ad-hoc
- Inspektimi pasues



Inspektimi në teren nënkupton inspektim në zyrat e subjektit raportues i cili mund të jetë, inspektim me fushëveprim të plotë, inspektim me fushëveprim të kufizuar dhe inspektim tematik.

Gjatë vitit 2014 janë realizuar gjithsej 35 inspektime të pajtueshmërisë në subjektet raportuese, (25) inspektime me fushëveprim të plotë, (9) inspektime me fushëveprim të kufizuar si dhe (1) inspektim Ad-hoc.

2014				
Subjektet raportuese	Lloji inspektimit			
	Fushëveprim i plotë	Fushëveprim i kufizuar	Ad-Hoc	Gjithsej
Banka ³	2	7	0	9
Institucione Mikrofinanciare	5	//	//	5
Kompani të Sigurimit	4	//	//	4
Kompani të Sigurimit të Jetës	2	//	//	2
Zyrat e Këmbimit Valutor	7	//	//	7
Agjensione për transfere të parave	3	//	//	3
OJQ	4	//	1	5
Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë	27	7	1	35


Tabela nr.21 – Inspektimi i Pajtueshmërisë 2014

Në kuadër të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë disa nga fushat e inspektuar kanë qenë si në vijim:

- Programet e brendshme të shkruara bazuar në Ligjin 03/L-196 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-178 për bankat dhe institucionet financiare:
 - i. Procedurën për Identifikimin e Klientit/Njihe klientin tënd (KYC);
 - ii. Procedurën për Kujdesin e Duhur të Shtuar përfshirë (Personat e Ekspozuar Politikisht);
 - iii. Dokumentet e pranuar për identifikimin / verifikimin e klientit;
 - iv. Burimin e të ardhurave;
 - v. Kategorizimi i klientëve sipas rrezikshmërisë;
- Struktura organizative e zyrës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit (PPP/PFT)
- Analizimi i Transaksioneve në të Gatshme dhe Aktiviteteve të Dyshimta
- Raportimi i Transaksioneve në të Gatshme (RTG) dhe Raportimi i Aktiviteteve të Dyshimta (RAD)
- Procedimi i Kërkesave për Informata të NJIF-K
- Kopja dhe Mirëmbajtja e RTG-ve, RAD-ve dhe Informatave Plotësuese (AIF)
- Infrastruktura e raportimit në formatin XML dhe EXCEL

Duke pasur parasysh se viti 2014 ka qenë viti i parë i inspektimeve të pajtueshmërisë NJIF-K ka rekomanduar subjektet raportuese që të ndërmarrin veprimet e duhura për përmirësime në ato

³ Dy Banka janë inspektuar në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës bazuar në nenin 36A të ligjit në fuqi dhe Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet NJIF-K dhe BQK.



fusha ku ka hasur në mos-pajtueshmëri. Pas përfundimit të inspektimeve në terren NJIF-K në vitin 2015 do të vazhdoj me inspektimet pasuese me qëllim që të verifikoj nëse rekomandimet e dhëna janë përmbushur.

4.4. Informatat kthyese

4.4.1. Informatat kthyese nga Institucionet e zbatimit të ligjit

Informatat kthyese të pranuar nga NJIF-K tregojnë progres si në rritjen e numrit të kthimit të informatave kthyese, ashtu edhe në rezultatet përfundimtare të ndjekura penalisht dhe denuara për pastrim të parave. Numri i informatave kthyese të dërguara nga agjencionet e zbatimit të ligjit për vitin 2014 ka arritur në 129 raporte për rastet e referuara në institucionet e ndjekjes penale. Kryesisht këto informata kthyese kanë të bëjnë me rastet e përcjella në vitet 2010 - 2014. Dogana e Kosovës ka pasur numrin më të madhë të informatave kthyese të dërguara në NJIF gjatë këtij viti, e cila ka bërë njoftimin për 60 raste ose rreth 47% të gjithsej informatave kthyese, përderisa Policia e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës kanë bërë njoftimin për 35 respektivisht 29 raste.

Gjatë hetimeve ka rezultuar që dyshimet kryesore për veprat e ndërlidhura penale të rezultojnë me: pastrim të parave, shmangie nga tatimi, kontrabandë, krim i organizuar, mashtrim.

Në vitin 2014, Gjykata ka dënuar 8 persona për përfshirje në veprat penale si krimin e organizuar, pastrimin e parave, mashtrimin, shmangien nga tatimi, keqpërdorimin e besimit, falsifikimit të dokumenteve. Këta persona janë denuar me rreth 50 vite burgim dhe rreth 70,000 € gjobë si dhe është konfikuar pasuria e gjeneruar nga aktiviteti kriminal. Një pjesë e dënimit me burg dhe me gjobë është shqiptuar bazuar në nenin 32 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit duke përshkruar maskimin e origjinës së parave ose pronës tjetër të fituara nga ndonjë vepër penale, ku përfshihet:

- konvertimi ose çdo transfer i parave që rrjedhin nga aktiviteti kriminal;
- fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendit, lëvizjes, rregullimit, të drejtave, ose pronësisë në lidhje me paratë ose pronë tjetër të fituar nga aktivitetet kriminale

Hetimet nga Administrata Tatimore dhe Dogana e Kosovës gjithashtu kanë treguar që në rreth 17 raste ka pasur shmangie tatimore ose mosdeklarim real të qarkullimit, janë gjetur mallra pa origjinë dhe dyshime tjera, gjitha këto në vlerë prej rreth 3.9 milion Euro. Për disa nga këto raste është ngritur edhe kallximi penal në Prokurorin Speciale të Republikës së Kosovës për përfshirje të mundshme nën dyshimin e pastrimit të parave dhe shmangies nga tatimi.

Informacionet e pranura nga Policia e Kosovës kanë treguar se janë arrestuar disa persona të ndërlidhur me veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe janë sekuestruar pasuri të patundshme. Bazuar në informata kthyese, për pjesën më të madhe të rasteve është ngritur kallzim penal, përderisa disa nga ato raste janë ende nën hetime. Përderisa ka edhe raste për të cilat janë pushimuar hetimet ose mbyllur rastet.



4.4.2. Informatat kthyese për subjektet raportuese

Vitet e fundit NJIF-K ka filluar me implemetnimin e Udhëzimit për përdorimin e Praktikave më të mira të FATF në ofrimin e informacionit për institucionet financiare dhe subjektet e tjera raportuese për t'iu ndihmuar atyre t'i implementojnë në mënyrë të efektshme masat kombëtare për parandalimin e PP/FT, në veçanti në zbulimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta.

Është e rëndësishme të theksohet se NJIF-K ka shpërndarë për subjektet kryesore raportuese informatat kthyese në lidhje me procesin e analizës së transaksioneve të dyshimta duke specifikuar secilin RTD të pranuar gjatë një periudhe të caktuar dhe veprimet e ndërmarra nga njësia, kjo me qëllim të rritjes së kualitetit dhe efektivitetit të raportimeve. Për gjitha këto veprime është dërgu raport i veçantë tek subjektet raportuese në mënyrë individuale. Informacionet për veprimet e ndërmarra nga institucionet tjera të zbatimit të ligjit nuk janë përfshirë në ato informata kthyese, sepse ato përbëjnë informata të klasifikuara.

Në bashkëpunim me subjektet raportuese dhe palët e interesit janë draftuar edhe urdhëresat administrative për listat e indikatorëve të transaksioneve të dyshimta. Këto udhëzime do të hyjnë në fuqi në tremujorin e parë të vitit 2015.

4.5. *Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve*

Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës (NJIF-K) bazuar në nenin 14 paragrafi 1.10 të Ligjit Nr. 03/L-196 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit është institucion i cili në kuadër të mandatit ligjor ka kompetencë që të organizojë dhe/ose kryej trajnime në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste si dhe obligimet e subjekteve raportuese.

NJIF-K me qëllim të sigurimit dhe promovimit të pajtueshmërisë së subjekteve raportuese me ligjin në fuqi ka hartuar Udhëzimin Administrative 001/2013 i cili ka hyrë në fuqi me datë 31/10/2013 si dhe planin e trajnimeve për vitin 2014, ku parashihet dhënia e trajnimeve për subjektet raportuese të përcaktuara me ligjin për PPP/PFT.



Në kuadër të këtij plani NJIF-K ka organizuar për subjektet raportuese trajnimet si në vijim:

Data	Subjekti raportues	Nr.i personave	Tema	Mbështetësit
24/01/2014	Institucionet Mikrofinanciare	12	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	/
14/02/2014	Noterët	54	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe standardet minimale të raportimit Përpilimi i kontratave	Oda e Noterëve
10/3/2014	Kompanitë e Sigurimeve	25	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	/
29/04/2014	Kazinetë dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit	18	PPP/PFT, Obligimet ligjore, procedurat e brendshme dhe mënyra e raportimit	B&S Project B&S Project
15/05/2014	Partitë Politike	4	PPP/PFT, Obligimet ligjore	KQZ
28/05/2014	OJQ-të	16	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	B&S Project MAP-DRNOJQ
17/06/2014	Këmbimoret	28	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	B&S Project
30/06/2014	Bankat	12	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	B&S Project
25/10/2014	Avokatët Regjioni i Prizrenit	35	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe standardet minimale të raportimit	B&S Project Oda e Avokatëve
31/10/2014	Avokatët Regjioni i Prishtinës	33	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe standardet minimale të raportimit	B&S Project Oda e Avokatëve
14/11/2014	Auditorët	75	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe standardet minimale të raportimit	B&S Project SHKÇAK
22/11/2014	Avokatët Regjioni i Gjilanit	36	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe standardet minimale të raportimit	B&S Project Oda e Avokatëve

Tabela nr.22 – Trajnimet e mbajtura me Subjektet Raportuese

Trajnimet për vitin 2014 janë organizuar lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, obligimet ligjore si dhe mënyrën e raportimit. Gjatë trajnimeve subjektet raportuese janë njoftuar rreth ndryshimeve ligjore që ka pësuar Ligji Nr. 03/L-196, procesin e Vlerësimit të Rrezikut Kombëtarë, draft Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, udhëzimin administrativ për shqiptimin e sanksionet administrative dhe udhëzimin administrativ për personat e ekspozuar politikisht.



4.5.1. Implementimi i Programit të Trainimeve

Gjatë vitit 2014, ka vazhduar zbatimi i objektivave dhe aktiviteteve të dokumentit strategjikë “vlerësimi i nevojave për trajnim, Programi dhe Strategjia e Trajnimit për Njësinë e Intelegjencës Financiare dhe institucionet tjera të angazhuara në parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizimit dhe krimeve financiare në Kosovë”. Ky program është përgaditur në kuadër të kornizës së Projektit të financuar nga BE, “Mbështetje për institucionet e Kosovës në luftimin e krimit ekonomik dhe financiar”.

Për këtë qëllim, NJIF-K ka miratuar edhe një “urdhëresë administrative Nr. 001/2013 *trajnimet për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”. Përmes kësaj urdhërese administrative, përcaktohen dhe rregullohen procedurat dhe obligimet ligjore të subjekteve raportuese lidhur me trajnimet e ofruara nga NJIF-K. Ky dokument ka për fokus Trajnimet për subjektet raportuese dhe Trajnimet për institucionet e sundimit të ligjit dhe institucionet tjera.

4.5.2. Objektivat e Strategjisë së Trajnimit

Ideja kryesore e strategjisë së trajnimit mbështetet në atë se duhet të ketë organizim të kombinuar, përbashkët dhe trajnim gjithëpërfshirës në parandalimin dhe hetimin e shpërlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare dhe korrupsionit për të gjitha autoritetet relevante të cilat gjithashtu duhet të jenë përgjegjëse për planifikimin dhe implementimin e sistemit trajnues.

Sistemi i përbashkët do të garantojë që trajnerët të kenë informacion dhe praktikë të azhurnuar që pjesëmarrësit të mund të aplikojnë në punën e tyre të përditshme.


Një fokus në strategji i është kushtuar edhe kapaciteteve të qëndrueshme dhe uljes graduale dhe varësisë në instruktorët e huaj përmes zhvillimit të Trajnimit të Trajnerëve dhe ekspertizës së ndërtimit të kapaciteteve të brendshme.

Institucionet kryesore udhëheqëse, përgjegjëse për krijimin, zhvillimin dhe implementimin e Strategjisë së Trajnimit është Instituti i Krimeve Ekonomike me mbështetjen Grupeve Punuese të Koordinatorëve Trajnues për sektorët publik dhe privat.

4.5.3. Cikli i zhvillimit të trajnimit

NJIF-K dhe institucionet tjera përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe krimet ekonomike duhet të vlerësojnë vazhdimisht mjedisin ku operojnë. Ato duhet të vlerësojnë ndryshimet strategjike dhe operationale të cilat ndikojnë në nevojat për trajnim. Mekanizmi i vlerësimit të riskut kombëtar paraqet një bazë solide për këtë proces. Institucionet përkatëse duhet të ndryshojnë strategjinë dhe programin e trajnimit në mënyrë që të mund të ballafaqohen me kërkesat e reja të cilat dalin nga vlerësimi i rrezikut kombëtar. Grupet punuese për koordinimin e trajnimit duhet të përfshihen në proceset vendimmarrëse për ndryshimin e strategjisë.





Burimi: Ekipi i projektit B&S

4.5.4. Struktura e programit të trajnimit

Struktura e programit të trajnimit është e ndarë në dy komponenta kryesore:

- ✓ seminarët dhe puntoritë për institucionet publike, private dhe sektorët e tretë dhe
- ✓ trajnime për subjektet përgjegjëse për raportimin sipas legjislacionit të PPP/PFT

Përderisa, Programi i trajnimit është i ndarë në shtatë (7) seksione:

- Trajnimi bazik,
- Analizimi i intelgjencës në mjedisin financiar,
- Hetimi i krimit financiar,
- Metodët speciale të hetimit,
- Trajnim mbi funksionet e përputhshmërisë,
- Trajnim mbi vetëdijesimin dhe komunikimin si dhe
- Trajnim i trajnerëve.

Modelet të cilat variojnë nga ato më bazike deri te ato më të specializuara përfshijnë:

- ✓ Trajnimi bazik për hetimin e krimit financiar
- ✓ Analizat operacionale
- ✓ Analizimi i pajisjeve të teknologjisë informative
- ✓ Hetimi i Korrupsioni
- ✓ Hetimi i shkeljeve në taksa
- ✓ Hetimi i kontrabandës dhe shkeljeve në të hyrat doganore
- ✓ Hetimi i krimeve që ndërlidhen me prokurimin
- ✓ Hetimi i pastrimit të parave
- ✓ Hetimi i financimit të terrorizmit
- ✓ Hetimi i krimeve të teknologjisë informative
- ✓ Bashkëpunimi ndërkombëtar në hetimin e krimeve ekonomike
- ✓ Drejtimi i hetimeve të krimit financiar
- ✓ Kontabiliteti forenzik dhe auditimi
- ✓ Forenzika e TI në hetimin e krimit financiar
- ✓ Gjurmimi i të ardhurave nga krimi
- ✓ Trajnim mbi funksionet e përputhshmërisë
- ✓ Hyrje në marrëdhëniet me publikun
- ✓ Trajnim i specializuar në fushën e marrëdhënieve me publikun, dhe
- ✓ Trajnimi për trajner



Trajnime shtesë do të ofrohen për institucionet e sektorit publik dhe privat, veçanërisht për palët të cilat janë të obliguara të raportojnë transaksionet e dyshimta bankare dhe me para të gatshme, siç përcaktohet me legjislacionin e PPP/PFT.

4.6. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes

Objektivi i parë i Planit të Veprimit të Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare është “Ngritjen e vetëdijes për ndikimet në ekonomië joformale dhe krimeve financiare” i cili objektivi ngërthen në vete disa aktivitete që për fokus kanë ngritjen e vetëdijes.


Me qëllim të përmbushjes së këtij objektivi, NJIF-K ka organizuar fushata, konferenca, punëtori me entitetet e sektorit publik, privat dhe të tretë me qëllim të përmirësimit të parandalimit të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit dhe për të rritur njohuritë e publikut rreth rolit të NJIF-K. Gjithashtu NJIF-K ka përgatitur një reklamë në Televizionin Publik për të rritur vetëdijën për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit si dhe për të njoftuar publikun rreth legjislacionit për PPP/PFT dhe raportimit në NJIF-K.

Ngritjen e vetëdijes së subjekteve raportuese dhe shoqërisë, me anë të aktiviteteve informuese dhe trajnuese dhe formave tjera të përcaktuara me ligj, kanë qenë prioritetet tjera të Njesisë. Njëherit, si vazhdimësi e një bashkëpunimit të ngushtë me subjektet raportuese, NJIF-K ka vazhduar me formën e takimeve individuale me të detyruarit ligjrisht, duke u fokusuar në takimet periodike me të gjitha bankat komerciale në vend si dhe shoqatën e bankave, pastaj janë mbajtur takime të veçanta edhe me shoqatën e noterëve të Kosovës, Shoqatën e Institucioneve Mikrofinanciare, Shoqatën e Kompanive të Sigurimeve, Shoqatën e Avokatëve si dhe me Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës. Këto takime kanë rezultuar mjaft pozitive, ku janë diskutuar dhe shtjelluar format më të mira të raportimit, njëherit NJIF-K u ka ofruar rekomandime dhe udhëzime për çështje që lidhen me përmbushjen e obligimeve ligjore të tyre dhe bashkëpunimin sa më efektiv e reciprok. Falë këtij bashkëpunimi me disa nga ato shoqata është hartu edhe plani dhe programi i përbashkët vjetor i trajnimeve.

4.6.1. Konferenca Ndërkombëtare

Në vitin 2014, zyrtarët e NJIF-K kanë qenë pjesëmarrës në disa konferenca të mbajtura në vend ose jashtë vendit. Në disa nga këto konferenca NJIF-K ka qenë bashkorganizatore, përderisa në të tjerat vetëm si pjesëmarrëse. Në vijim janë konferencat në të cilat zyrtarët e NJIF-K kanë marrë pjesë:

- ✓ *Seminarin Rajonal për pasurin e konfiskuar dhe sekuestruar (mbajtur në Prishtinë, Prill 2014)*
- ✓ *EU Twinning Project kick-off Conference “Fuqizim i kapaciteteve të hetimeve kriminale kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit”*



- ✓ *Konferenca Rajonale: "Intensifikimi i Bashkëpunimit, Tejkalimi i sfidave ekonomike, rritja e bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe bashkimi i përpjekjeve kundër ekonomisë joformale (mbajtur në Prishtinë, Maj 2014);*
- ✓ *Konferencën për Parandalimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimin Financiar (mbajtur në Prishtinë, Maj 2014);*
- ✓ *Takimi i dytë ndërkombëtar i grupit të përdoruesve të goAML (mbajtur në Marakech Maroko, Shtator 2014)*
- ✓ *Konferenca Ndërkombëtare mbi Përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (mbajtur në Prishtinë, Shtator 2014);*
- ✓ *Konferenca Ndërkombëtare mbi Përmirësimin e Bashkëpunimit në fushën Kundër Korrupsionit (KK) - (mbajtur në Prishtinë, Tetor 2014)*
- ✓ *Konferenca për Parandalimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare (mbajtur në Prishtinë, dhjetor 2014)*
- ✓ *Takimi Plenar i Projektit Kundër Krimin Ekonomik në Kosovë PECK (mbajtur në Prishtinë, dhjetor 2014).*

Në shumicën prej këtyre konferencave kanë marrë pjesë edhe sektori privat dhe shoqëria civile, të cilët kanë pasur mundësin të jenë sa më afër diskutimeve dhe prezantimeve të bëra nga ekspertët e ndryshëm të fushave përkatëse, përmes së cilave njohurit e tyre janë ngritur edhe më tepër rreth rëndësisë dhe mënyrës së luftimit dhe parandalimit të përbashkët të veprave dhe dukurive negative të krimeve të ndryshme financiare.

4.7. Publikimi i Tipologjive

Publikimi i Tipologjive një vit më parë ka ndikuar në ngritjen e vetëdijes dhe të kuptuarit e fenomeneve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke rezultuar në kualitetin e raporteve të dyshimta të raportuara nga subjektet raportuese, por njëherit edhe në ngritjen e interesimit për ofrimin vullnetar të informacioneve për dyshimet në lidhje me shpërlarjen e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste apo veprave të ndërlidhura penale.

Një publikim i tillë i tipologjive do të vazdoj edhe në vitet pasuese duke përfshirë edhe raste dhe situata tjera ilustruese me indikatorë të ndryshëm të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe me qëllim të zbulimit dhe luftimit të dukurive negative të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

4.8. Rritja e kapacitetit të NJIF

4.8.1. Teknologjia Informative

Nga viti 2009, subjektet raportuese kanë filluar të raportojnë përmes sistemit të avancuar goAML. Kjo formë e raportimit ka zëvendësuar formatin klasik të raportimit, duke kaluar në sistemin elektronik të raportimit. Përveç raportimit, nga viti 2010 është instaluar edhe komunikimi elektronik i shkëmbimit të të dhënave me subjektet raportuese, institucionet publike, dhe një pjesë të homologëve ndërkombëtar.



Një progres i qëndrueshëm ka vazhduar në avancimin e Sistemit për Analiza, Raportim dhe Shkëmbim të informacioneve goAML, e cila si objektiv ka pasur edhe rritjen e kualitetit të Inteligjencës dhe efikasitetin e Analizave. Në këtë progres kontribut të madh ka dhënë edhe Projekti i financuar nga BE-ja.



Gjithashtu gjatë kësaj periudhe sistemi goAML ka kaluar në versionin 4.0 i cili ofron mundsi të reja të cilat deri më tani nuk kanë qenë të mundura. Disa nga avancimet e shumta të cilat janë prezente në versionin e ri të goAML:

- ✓ Mundësi e mbrojtjes sistimore (teknike) të rasteve,
- ✓ Shpejtësi më e madhe e përpunimit të të dhënave
- ✓ Shtim i veglave për Vizualizim me anë të diagrameve
- ✓ Rritje e mundsive për kontrollimin e të dhënave të raportuara
- ✓ Vlerësim sistemor i rrezikut për secilin rast në goAML

Score:	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	>10
Icon:	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- ✓ Krijimi i tipeve të reja të raporteve përmes të cilave është përfshirë i gjithë aktiviteti i NJIF-K.
- ✓ Evitim i duplikimeve të raportuara në sistem nga Obligorët me veglën Merging.

Gjatë tërë vitit 2014 ka vazhduar integrimi i të gjitha Agjensive dhe Subjekteve Raportuese të cilat kryejnë komunikime elektronike të përditshme me NJIF-K në sistemin goAML Message Board.

NJIF-K ka vazhduar me avancimin e Sistemit të Raportimit përmes goAML duke arritur progres në rritjen e kualitetit të të dhënave të cilat raportohen në NJIF-K. Progresi u arrit falë një



koordinimi të mirë të Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Departamentit të Pajtushmërisë të cilat realizuan Inspektime të Përbashkta në Banka dhe Subjekte tjera raportuese.

Po ashtu pati një bashkpunim të mirë edhe me Banka dhe Subjekte tjera raportuese dhe atyre ju prezentua një projekt teknik ideor me veprimet të cilat duhet të ndërmirren me qëllim të përmisimit të kualitetit të raporteve.

Procedurës Standarde të Veprimit janë hartuar dhe finalizuara nga ekspertët e projektit të cilat janë integruar në proceset ditore të punës bazuar në goAML.

Pas Policisë së Kosovës, NJIF-K ka krijuar edhe një sistem të ri me ATK i cili i nxjerr, krahason dhe paraqet vizualisht përmes goAML të dhënat e marra nga Baza e të Dhënave të ATK-së dhe sistemit goAML. Ky sistem i ri pritet që dukshëm të lehtësoj procesin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Po ashtu është hartuar Procedura Standarde e Ndërveprimit (NJIF-K dhe ATK) që definojnë bazën ligjore dhe zgjidhjen teknike.


Faqja e re zyrtare e njësisë është finalizuar dhe kompletuar (<http://fiu.rks-gov.net/>). NJIF-K e ka zhvilluar uebfaqen për të komunikuar me subjektet raportuese në mënyrë shumë efikase. Ky proces është kompletuar falë edhe mbështetjes nga Projekti i financuar nga BE-ja. Uebfaqja do të jetë funksionale në fillim të vitit 2015.

NJIF-K ka realizuar me sukses 100% të buxhetit vjetor të Njësisë të alokuar për Investime Kapitale. Investimet në Harduer (Kompjuterët, paisjet tjera) janë integrua tërësisht në sistemin aktual në përdorim duke e rritur ndjeshëm kapacitetin e Analizave përmes Sistemit të Sigurtë.

4.8.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NJIF-K

Stafi i NJIF-K ka ndjekur një numër të konsiderueshëm të trajnimeve të nivelit strategjik dhe operacional për menaxhment, administratë, inteligjencë financiare, analiza dhe hetime në përgjithshme por në veçanti sa i përket pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit. Trajnimet janë organizuar si nga institucionet vendore ashtu edhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Ngritja e kapaciteteve të stafit profesional në njësi është përcjell edhe me pjesmarrje në seminare ose konferenca të ndryshme, qofshin ato vendore ose ndërkombëtare. Gjatë vitit 2014 ka vazhduar zbatimin i objektivave dhe aktiviteteve të dokumentit strategjikë “vlerësimi i nevojave për trajnim, Programi dhe Strategjia e Trajnimit për Njësinë e Intelgjencës Financiare dhe institucionet tjera të angazhuara në parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë”. Personeli i NJIF-K ka marrë pjesë në gjithsej 30 trajnime dhe seminare vendore dhe ndërkombëtar, nga të cilat 23 ishin të ndërlidhura me parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit ose veprave tjera të ngjashme.



Disa nga trajnimet vendore kryesore në të cilat stafi i NJIF-K ka marrë pjesë, kryesisht përmbanin temat si në vijim:

Data	Titulli	Organizatori	Numri i pjesëmarrësve nga NJIF-K
17 Janar 2014 dhe 20 Shkurt 2014	Përcjellja e parasë	IKKE	2
27 - 29 Janar 2014	Mbikqyrja e pajtueshmërisë në PPP/LFT	B & S	11
20 Mars 2014	Kodi penal dhe kodi i ri i procedurës penale me fokus në masat shtrënguese	B & S	2
03 - 09 Prill 2014	goAML upgrade	UNODC	9
15 - 16 Prill 2014	Seminari Rajonal organizuar nga AAPSK (AMSCA)	AMSCA & BE	1
26 - 29 Maj 2014	Financimi i Terrorizmit	B & S	1
14 - 16 Korrik 2014	Udheheqja e hetimeve të krimeve financiare	IKKE	1
23 - 27 Korrik 2014	Hetimi i Pastrimit të parave, gjurmimi i aseteve dhe asistencë e përbashkët nderkombetare ligjore	IKKE	1
09 Shtator 2014	Gjurmimi i aseteve, sekuestrimi dhe konfiskimi	IGJK dhe B & S	2
08 - 10 Shtator 2014	Hetimi i Kontrabandes dhe veprave doganore dhe të taksave	IKKE	1
26 - 27 Shkurt 2014	Punetori mbi mbledhjen, mbajtjen dhe raportimin e statistikave	PECK	2
27 - 31 Tetor 2014	Trajnim për goAML	B & S	9

Tabela nr.23 - Trajnimet kryesore vendore të ndjekura nga stafi i NJIF-K



Stafi profesional i NJIF-K, gjithashtu ka marrë pjesë në trajnimet dhe aktivitetet tjera ndërkombëtare, të organizuara në nivel rajonal dhe ndërkombëtar:

Data	Titulli	Vendi	Numri i pjesmarreve nga NJIF-K
1 - 6 Qershor 2014	Takimi i 22 Plenar i Egmont Grupe	Lima, Peru	2
5 Qershor 2014	Metodat e reja të pagesave të ndjekura për financim të terrorizmit	Lima, Peru	1
5 Qershor 2014	Roli i FIUs në Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar	Lima, Peru	1
5 Qershor 2014	Roli i FIUs në luftën kundër korrupsionit dhe rikthimin e aseteve	Lima, Peru	2
16 - 19 Qershor 2014	Punëtori: Rikthimi i aseteve – qasja shumë drejtimëshe	Brussels, Belgium	1
22 - 25 Shtator 2014	Trajnimi lidhur me bartjen e parasë në dorë UNODC/GPML	Ohër, Maqedoni	1
29 Shtator - 03 Tetor 2014	Vizitë Studimore, Finlandë	Helsinki, Finlande	6
29 - 30 Shtator 2014	Takimi i dytë i përdoruesve të goAML	Marakech, Morocco	2
2 - 5 Nëntor 2014	Takim ballë për ballë lidhur me vlerësimin e PECK - KiE Strasburg	Strasburg, France	2

Tabela nr.24 - Trajnimet dhe takimet kryesore ndërkombëtare të ndjekura nga stafi i NJIF-K



5. BASHKËPUNIMI VENDORË DHE NDËRKOMBËTAR

5.1. *Bashkëpunimi dhe koordinimi kombëtar*

Me qëllim të angazhimit ndër-institucional është e rëndësishme që të krijohen mekanizma të përbashkët për shkëmbim të informacioneve mes agjencioneve të cilat kanë përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar.

Vlerësimi i rrezikut për shpëlarje të parave dhe financim të terrorizmit është miratuar nga qeveria. Për të ndërtuar një mekanizëm gjithëpërfshirës për menaxhim të rrezikut dhe trajtuar rreziqet e identifikuara, qeveria ka hartuar strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për parandalimin dhe luftën kundër ekonomisë joformale, shpëlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018. Ky mekanizëm gjithëpërfshirës mes tjerash përfshin: Grupin e përhershëm qeveritar (GP) i cili aprovon raportin e gjendjes faktike dhe raportin në Qeveri, ndihmon në hartimin, rishikimin, dhe monitorimin e strategjisë kombëtare, pastaj Sekretariatit i cili harton raportin e gjendjes faktike për implementimin e strategjisë për GP qeveritare dhe mbështet GP qeveritarë, dhe në fund Zyrtarët përgjegjës për implementimin e strategjisë apo grupi teknik i cili Raporton për të arriturat tek përfaqësuesit e institucioneve në sekretariat.

Për realizimin e misionit të përbashkët të institucioneve në fushën e zbatimit të ligjit është me rëndësi të themelohen edhe mekanizma për caktim dhe koordinim të detyrave të nivelit strategjik ku do të përfshihen strukturat më të larta të institucioneve si dhe më pas caktimin dhe koordinimin e detyrave në nivel operacional. Kjo ka për qëllim gjithashtu të mundësojë një qasje ndër-institucionale në përcaktimin e prioritetëve në fushën kundër krimit financiar në mes të agjencioneve si dhe do të jetë në funksion të zbatimit të procedurave standarde të veprimit për përzgjedhjen dhe shënjestrimin e krimeve të rënda dhe bashkëpunimin ndër-institucional.

Me ndërtimin e këtyre mekanizmave do të mundësohet një qasje e përbashkët ndër-institucionale për caktim dhe koordinim të detyrave në nivelet strategjike dhe taktike. Takimet për Caktimin e Detyrave dhe Koordinimit u mundësojnë Ekipeve të Menaxhereve të Lartë të Institucioneve të marrin vendime mbi prioritetet e përbashkëta të të gjitha institucioneve.

Për këtë qëllim në fund të vitit 2014 është nënshkruar një marrëveshje gjithëpërfshirëse bashkëpunimi për shkëmbimin e informatave, vlerësimin e riskut dhe koordinim në mes të institucioneve dhe agjencioneve të zbatimit të ligjit për luftimin dhe parandalimin e krimeve ekonomike dhe financiare.

Gjithashtu, Zyra e Koordinatorit Kombëtare për Luftimin e Krimit Ekonomik shërben si një mekanizëm kyç i bashkërendimit dhe mbikëqyrjes për veprimtaritë e të gjithë akterëve shtetëror në fushën e luftimit të krimit ekonomik, përfshirë PP dhe FT. Kjo zyre është krijuar me qëllim të rritjes së efikasitetit në ndjekjen penale të krimeve, sekuestrimin dhe konfiskimin e përfitimeve materiale që burojnë nga krimi.



Partnerët kryesorë të bashkëpunimit të NJIF-K janë Prokuroria e Shtetit, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Eulex, ATK, Dogana, BQK, AKI, Agjensioni kundër Korrupsionit dhe Agjensioni për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar.

Si fushë e mandatit ligjorë të NJIF-K mbetet edhe bashkëpunimi në mënyrë reciproke mes njësisë me institucionet dhe organet tjera në Kosovë, ndihma e ndërsjelltë gjatë kryerjes së detyrave të tyre, si dhe koordinimi i aktiviteteve në kuadër të kompetencave të tyre. Në këtë drejtim shkëmbimi i informatave mbetet një nga komponentët e rëndësishme të NJIF-K, me qëllim të ndihmës së ofruar gjatë mbledhjes indirekte të provave dhe për të rritur efikasitetin përmes metodave dhe praktikave ndërkombtarisht të përdorura për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, konsfiskimin e aseteve ose veprave penale të ndërlidhura. Njëherit, NJIF-K fokusohet në rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional sidomos me agjensionet e zbatimit të ligjit, me qëllim të shkëmbimit sa më efikas të informacioneve.

Numri i kërkesave për informata gjatë vitit 2014 ka qëndruar në numer të përafërt me vitin paraprak, mirpo krahasuar me dy vitet e mëparshme, ka një rritje të theksuar të shkëmbimit të informatave në mes institucioneve e cila tregon për një ngritje të bashkëpunimit me institucionet të zbatimit të ligjit, rritjen e besueshmërisë dhe rëndësinë e informacioneve të Njësisë për Inteligjencë Financiare dhe rritjes së profesionalizmit të këtij institucioni. Bashkëpunimi më i theksuar vërehet me Policinë e Kosovës e cila përbën rreth 50% të kërkesave për informata. Këto kërkesa janë bazuar kryesisht në informacione shtesë përkitazi me rastet e mëhershme të përcjella nga NJIF-K për institucionet gjegjëse, ose për dyshimet e ngritura nga këto institucione në lidhje me veprat penale për pastrim të parave, financim të terrorizmit ose veprave të ndërlidhura.

Më poshtë është paraqitur numri i kërkesave të parashtruara nga disa prej institucioneve kryesore me të cilët bashkëpunon NJIF-K, ku numri i përgjigjeve ka qenë përafërisht i ngjajshëm. Kishte edhe kërkesa për informata të cilat janë refuzuar nga NJIF-K, me arsyen se nuk kishin të bënin me mandatin ligjorë të njësisë.

Institucionet parashtruese të kërkesës	2011	2012	2013	2014
Policia e Kosoves	21	28	57	91
AKI	0	5	14	23
EULEX	16	15	8	11
Prokuroria Speciale e Kosovës	4	4	1	6
Prokuroria e Shtetit	0	0	5	6
Administrata Tatimore e Kosovës	1	2	20	7
Dogana e Kosoves	18	44	61	25
ILECUs	0	2	15	6
Tjera	4	3	2	2
Gjithsej	64	103	183	177

Tabela nr.25 - Kërkesat për informata (RFI) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF-K

5.1.1. Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale

Fokus i veçantë gjatë këtij viti i është kushtuar implementimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Detyrat e punës për secilin aktivitet janë shpërndarë tek zyrtarët kompetentë të njësisë, dhe raportimi bëhet në baza të rregullta periodike. Implementimin e objektivave dhe aktivitetve të Planit të Veprimit të njësisë e monitoron anëtari i sekretariatit të Strategjisë, përdërisa raportin e përmbushjes së atyre aktivitetve e miraton Grupi i Përhehrshëm Qeveritar.

Përveç kësaj, NJIF-K ka vazhduar me dhënjën e kontributit në implementimin dhe rishikimin e tri strategjive kombëtare duke qenë pjesëmarrëse aktive në: Strategjinë Kombëtare kundër krimit të organizuar, Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit dhe Strategjinë kombëtare për parandalimin e krimit.

5.1.2. Memorandumet e Mirëkuptimit

Me qëllim forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dhe bashkërendimit si dhe të rritjes së bashkëpunimit në mënyrë reciproke, të ndihmës së ndërsjelltë të njëra tjetrës gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe të koordinimit të aktivitetve në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme, NJIF-K dhe institucionet tjera të zbatimit të ligjit dhe ato publike, kanë vazhduar nënshkrimin e marrëveshjeve të tilla të bashkëpunimit.

Një marrëveshje gjithëpërfshirëse bashkëpunimi për shkëmbimin e informatave, vlerësimin e riskut dhe koordinim në mes të institucioneve dhe agjencioneve të zbatimit të ligjit është nënshkruar nga Prokuroria e Shtetit, Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Njësia e Inteligjencës Financiare. Përmes kësaj marrëveshjeje institucionet do të harmonizojnë politikat e tyre me qëllim të shkëmbimit, analizimit dhe shpërndarjes së informacioneve në mes agjencioneve.

Qëllimi i kryesor i kësaj marrëveshjeje është krijimi i një sistemi i cili vepron në formë më proaktive ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj rendit dhe sigurisë në veqanti kërcënimet dhe rreziqet të cilat janë pasojë e veprimitarisë kriminale. Po ashtu fokus tjetër i kësaj marrëveshjeje është të siguroj që resurset të cilat janë në dispozicion të të gjitha institucioneve të përdorën bashkarisht në funksion të parandalimit dhe hetimit të krimit, si dhe adresimin e shqetësimeve kryesore për komunitetin në fushën e sigurisë. Kjo në veqanti do të mundësoj që të shfrytëzohen bashkarisht burimet njerëzore në dispozicion, njohuritë, sistemet e teknologjisë Informative dhe burimet e informatave në posedim të institucioneve.

Një marrëveshje tjetër bashkëpunimi ishte nënshkruar në Nëntor 2014, në mes të Njësies për Inteligjencë Financiare dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të përmiresoj bashkëpunimin mes dy institucioneve, ARC dhe NJIF-K, për të rritur parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke siguruar shkëmbim të informatave përmes qasjes në bazëne e të dhënave mes institucioneve nënshkruese. Sa i përket menyrës se si do të këmbehen të dhenat, kjo marrëveshjeje do ta ketë të bashkangjitur një Procedure Standarde të Operimit për shkëmbimin e të dhënave.



5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont

5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve

NJIF-K mund të pranoj dhe analizojë raportet dhe informacionet që i janë ofruar NJIF-K-së nga NJIF e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, nga gjykatat ose nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare e ndërkombëtare, organet publike ose qeveritare. NJIF-K gjithashtu në kuadër të kompetencave që i janë dhënë me ligjin për PPP/PFT mundet që spontanisht ose me anë të kërkesës, të ndajë informacionet me çdo agjenci homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht nga natyra e agjencisë e cila i nënshtrohet reciprocitetit. Informacioni i ofruar përdoret vetëm me miratimin e agjencisë dhe vetëm për qëllime të luftimit të shpërlarjes së parave, të veprave të ndërlidhura penale dhe të financimit të terrorizmit.

NJIF-K është në gjendje për të shkëmbyer ndërkombëtarisht të gjitha informatat që mund të jenë të arritshme apo të mundura direkt ose indirekt nga NJIF-K.


Bashkëpunimi ndërkombëtar	2011	2012	2013	2014
KËRKESAT E PRANUARA DHE SHPËRNDARA				
Kërkesat e NJIF-ve të huaja të dërguara në NJIF-K	10	10	7	19
Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF-K	12	13	6	20
Kërkesat e huaja të refuzuara nga NJIF-K	0	0	0	0
Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave ndaj FIU të huaj	49	33	26	29
Ndarja spontane e informacioneve				
Informacioni Spontan i pranuar nga NJIF-K	0	0	2	1
Informacioni Spontan i shpërndarë nga NJIF-K	//	//	3	6

Tabela nr.26 – Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2011-2014

Viti 2014 ka shënuar ngritje të bashkëpunimit ndërkombëtar në shkëmbimin e informacioneve, duke pasur ngritje të numrit të kërkesave të dërguara në drejtim të NJIF-K nga FIU e huaja ndërkombëtare.

Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NJIF-K	2014
FIU Shqipëri	1
FIU Austria	1
FIU Bulgaria	2
FIU Kroacia	1
FIU Maqedonia	2
FIU Mali i Zi	2
FIU Slovenia	2
FIU Switzerland	2
Agjensionet ndërkombëtare të zbatimit të ligjit	6
Gjithsej	19

Tabela nr.27 – Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NJIF-K 2014



Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF-K	2011	2012	2013	2014
FIU Maqedonia	6	5	1	3
FIU Mali i Zi	2	6	5	3
FIU Kroacia	-	1	-	1
FIU Holanda	-	1	-	-
FIU Shqipëri	2	-	-	1
FIU Bosna dhe Hercegovina	1	-	-	-
FIU Gjermani	1	-	-	-
FIU Austri	-	-	-	1
FIU Bulgari	-	-	-	2
FIU Sloveni	-	-	-	2
FIU Switzerland	-	-	-	2
Agjensionet ndërkombëtare të zbatimit të ligjit	-	-	-	5
Gjithsej	12	13	6	20

Tabela nr.28 – Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NjIF-K

Përveç kësaj, këtë vit kishte edhe ngritje të dërgimit të informacionit spontan të shpërndara nga NJIF-K për tek njësitë tjera homologe:

Informacioni Spontan i shpërndarë nga NjIF-K	2013	2014
FIU Belarusi	-	1
FIU Lithuani	-	1
FIU Poloni	-	1
FIU Maqedoni	1	1
FIU Cyprus	-	1
FIU Gjermani	-	1
FIU Luxemburg	1	-
FIU Mali i Zi	1	-
Gjithsej	3	6

Tabela nr.29 – Informacioni Spontan i shpërndarë nga NJIF-K 2013-2014

Për më tepër NJIF-K mund të bëj publike informacionet për organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ato organe që kryejnë funksion të ngjashëm me NJIF-K, jashtë Kosovës, nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente ose do t'i ndihmonte NJIF-K-së që të kryejë funksionet e saj.

Të gjitha të dhënat, informacionet dhe dokumentet zyrtare bëhen publike nga NJIF-K-ja vetëm për qëllime inteligjence, me qëllim të ofrimit të bazës për hetime. Ato nuk mund të përdoren si prova përpara një Gjykate.



Kërkesat e NJIF-K drejtuar FIU tjera homologe	2014
FIU Shqipëri	6
FIU Gjermani	4
FIU Turqi	4
FIU Itali	3
FIU Ukraine	2
FIU Austri	1
FIU Bosna dhe Hercegovina	1
FIU Cyprus	1
FIU Holanda	1
FIU Maqedonia	1
FIU Suedi	1
Gjithsej	25

Tabela nr.30 – Kërkesat e NJIF-K drejtuar FIU tjera homologe 2014

Neni 36 i ligjit për PPP/PFT specifikon që autoritetet kompetente të Kosovës ndërmarrin sigurimin e masave më të gjera të mundshme të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja me qëllim të këmbimit të informacioneve, hetimeve dhe procedurave gjyqësore në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim lidhur me mjetet e shpëlarjes së parave dhe pasurinë e fituar me anë të veprës penale dhe me qëllim të ndjekjes së kryerësve të shpëlarjes së parave dhe aktivitetit terrorist. Një kërkesë sipas kësaj do të dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike në pajtim me ligjet dhe marrëveshjet në fuqi, i cili do të përcjellat tek Zyra e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar ose autoriteti tjetër kompetent.

5.2.2. Bashkëpunimi regional

Gjatë vitit 2014 janë zhvilluar dy takime pune në mes të NJIF-K dhe homologëve të tyre nga NJIF Shqipërisë. Këto takime pune janë mbajtur në Prill dhe Shtator dhe delegacionet ishin të udhëhequra nga Drejtorët e dy institucioneve. Qëllim i i vizites ishte diskutimi mbi çështjet me interes të përbashkët në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, shkëmbimit të informacionit mes dy njësive, rreziqet me të cilat vendet tona përballen në fushën e terrorizmit, rritja e kapaciteteve profesionale dhe teknike si dhe përcaktimi i fushave të bashkëpunimit në këtë drejtim, ecuria e anëtarësimit të NJIF-K në organizmat ndërkombëtar dhe hapat e ndërmarrë në funksion të mbikëqyrjes së subjekteve raportuese.

Në takimin e dytë të mbajtur në Tiranë si pjesë e programit të atij takimi ishte edhe nënshkrimi i marrëveshjes së re të bashkëpunimit mes dy njësive e cila do të shërbejë si bazë për forcimin e mëtejshëm të kooperimit në drejtim të shkëmbimit të informacionit, rritjen e rolit të tyre në kuadrin e forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve në vëndet respektive si dhe ndërmarrjen e takimeve periodike për të ndjekur në vijimësi bashkëpunimin institucional.





Takim i Drejtorit të NJIF-K me homologun e tij nga FIU Shqipëri

5.2.3. Memorandumet e Mirëkuptimit

NJIF-K parasheh që të fuqizohet edhe më tutje bashkëpunimi ndërkombëtar me NJIF të shteteve tjera. NJIF-K për momentin ka marrëveshje bashkëpunimi me shtetet e rajonit, BE dhe vende tjera. Objektivi i NJIF-it është që të ndërtojë marrëdhënie bashkëpunimi dhe të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me sa më shumë shtete sa i përket këmbimit të informacioneve që lidhen me pastrimin e parave dhe/apo financimin e terrorizmit.

Në vitin 2014, numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit ka arritur në 10. Me qëllim të -ngritjes së bashkëpunimit, NJIF Kosova dhe NJIF Poloni kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit e cila do të rritë edhe më tutje bashkëpunimin në mes të njësive tona të inteligjencës. Në vitin 2014, janë kryer dy vizita pune dhe studimore nga ana e NJIF-K, ku janë vizituar NJIF e Shqipërisë si dhe është kryer edhe një vizitë studimore në institucionet kryesore shtetërore në Finlandë. Njëherit FIU e Shqipërisë ka vizituar Kosovën.

Memorandumet e Mirëkuptimit me FIU ndërkombëtare			
Juridiksioni	Viti	Juridiksioni	Viti
Shqipëri (DPPPP)	2009	Turqia (MASAK)	2012
Maqedoni (MLPD)	2009	Republika Çeke (FAU-CR)	2012
Mali I Zi (APML)	2009	Finlanda (FIU)	2013
San Marino (FIA)	2009	Polonia (GIIF)	2014
Sllovenia (OMLP)	2009	Shqipëri (DPPPP)	2014
Kroaci (AMLO)	2010		

Tabela nr.31 - Memorandumet e Mirëkuptimit me NJIF ndërkombëtare

5.2.4. Procesi i Anëtarësimit në organizata ndërkombëtare

Interesimi i integritit të NJIF-K në organizatat ndërkombëtare është një proces të cilit njësisia i ka kushtuar një rëndësi të veçantë dhe është duke bërë përpjekje maksimale që krahas integritit të vendit tonë në institucionet e ndërkombëtare të përcjellat kjo agjendë edhe nga ana e NJIF-K.


Një aplikim për antarësim në Egomnt Group⁴ ishte bërë qysh në vitin 2013 duke paraqitur kërkesë zyrtare pranë Sekretariatit të këtij institucioni ndërkombëtar. Fillimisht është iniciuar procesi me mbështetjen e NJIF Finlandë, NJIF Senegal dhe NJIF Slloveni të cilat aprovuan sponsorizimin bazuar në kërkesën e NJIF-K.

Procedura për anëtarësimin e NJIF-K ishte përfshirë në agjendën e mbledhjes së grupeve punuese të Egomntit e cila është mbajtur në Budapest në Shkurt të 2014. Është vendosur që procesi duhet të vazhdohet dhe Sponsorat e NJIF-K duhet t'u lejohet të mbajnë vizitën në terren.

NJIF e Finlandës, Senegalit dhe Sllovenisë kanë mbajtur vizitën në terren në Prill të vitit 2014. Shtetet sponsore të NJIF-K kanë përgaditur një raport të vlerësimit të vendit tonë. Gjatë vizitës në terren, ekipi i sponsorëve është takuar me palët kyçe të interesit për të parë dhe vlerësuar nivelin dhe vullnetin e vendit tonë për luftën kundër PP/FTsi dhe përceptimin e tyre ndaj rolit të NJIF Kosovës. Përfundimi i raportit të sponsorëve ka konkluduar se NJIF-K i plotëson kërkesat për anëtarësim si anëtar i Grupit Egomnt.

Në të ardhmen e afërt, NJIF-K do të bëjë përpjekje për antarësim edhe në organizata tjera rajonale dhe ato ndërkombëtare, duke përfshirë këtu antarësimin në rrjetin e FIU-ve rajonale të ballkanit, pastaj antarësimin në MONEYVAL etj.

⁴ Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë



5.2.5. Egmont Group

Nga data 1 deri më 6 Qershorë 2014 në Lima të Perusë është mbajtur takimi i 22^{të} Plenar i Egmont Grupes në të cilin kanë marrë pjesë delegacionet nga 115 NJIF të ndryshme botërore si dhe rreth 15 organizat vëzhguese ndërkombëtare.



Me ftesë të sekretariatit të grupit Egmont, Drejtori i NJIF-K është ftuar për herë të parë (nga themelimi i NJIF Kosovë) të marrë pjesë në këtë takim me karakter ndërkombëtar. Ajo çfarë është e rëndësishme për vendin tonë përveç pjesëmarrjes, ishte edhe diskutimet e zhvilluara në dy grupet punuese të Egmontit, grupin mbështetës dhe atij ligjor, në të cilat është diskutuar përveç tjerash edhe antarësimi i NJIF Kosovë në këtë organizatë ndërkombëtare. Ky diskutim ka ardhur pas aplikimit për antarësim të NJIF-K në këtë organizatë të rëndësishme ndërkombëtare dhe pas diskutimeve të ngritura në grupin mbështetës në takimin paraprak të grupeve punuese të Egmont të mbajtur në Shkurt 2014 në Budapest.

Prezantimi i bërë nga delegacioni i Kosovës në atë takim plenar e forcoi edhe më tepër qëndrimin dhe bindjen se NJIF-K është funksionale, e pavarur dhe plotëson gjitha elementet e themelimit të një Njësie për Inteligjencë Financiare sipas standardeve ndërkombëtare. NJIF Kosova ka hyrë si vend kandidat për antarësim. Një kontribut jashtëzakonisht të çmuar në këtë drejtim ka dhënë edhe mbështetja e vazhdueshme dhe e palodhshme e shteteve sponsore të NJIF-K si NJIF Finlandë, NJIF Senegal dhe NJIF Slloveni të cilët prezantuan shkëlqyeshëm raportin e vlerësimit të vizitës në teren. Një mbështetje të fuqishme përkitazi me antarësimin e NJIF Kosovës kanë dhënë edhe një numer i konsiderueshëm i NJIF-ve tjera anëtare duke përfshirë edhe ato të rajonit.



Takimi 22 Plenar i Egmont Grup, Qershor 2014, Lima Peru

NJIF-K do të përpiqet të vazhdojë të jetë pjesamrreëse përsëri në takimet e ardhshme si atyre plenare ashtu edhe në grupet e ngushta punuese, kjo me qëllim që të ketë një shtrirje sa më gjithpërfshirëse, të shfrytëzohen eksperiencat e vendëve anëtare, të angazhohen kuadrot profesional të lamive të ndryshme.

Me qëllim të vazhdimit të rritjes së mëtutjeshme të rrjetit ndërkombëtar të regjimit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe shkëmbimin më efikas të informacioneve në takimin e 22^{të} Plenar, janë pranuar tetë (8) anëtare të reja në Egmont Grupe në mesin e të cilave janë NJIF nga Angola, Brunei Darussalam, Çad, Gana, Jamaica, Namibia, Sint Maarten dhe Tanzania, ku numri total i anëtarëve të njësive të inteligjencës ka arritur në 146.



Takimi 22 Plenar i Egmont Grup, Qershor 2014, Lima Peru



5.2.6. Takimi i dytë i grupit të përdoruesve të goAML

Nga data 29 deri më 30 Shtator 2014 në Marrakech të Marokos është mbajtur takimi i dytë (takimi i parë i mbajtur në Viene në 2012) ndërkombëtar i grupit të përdoruesve të goAML. Njësia e Inteligjencës Fiancaiare e Kosovës ishte pjesmarrës në këtë ngjarje me karakter ndërkombëtarë të përdoruesve softverit me emrin goAML, produkt softverik ky i UNODC, i dizajnuar enkas për Njësitë e Inteligjencës Financiare, lidhur me luftimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, sistem ky i instaluar në NJIF-K në vitin 2008 (ndër vendet e para të botës) dhe i cili është në përdorim operativ në NJIF-K që nga 2009. NJIF-K ka status të barabart në këtë grup, dhe kërkesat dhe sugjerimet e tij vijnë në konsiderate, barabarsisht me vendet tjera anëtare të këtij grupi.

Gjatë dy ditëve të konferencës janë diskutuar aspekte strategjike lidhur me softwerin goAML, funksionalitetin e tij dhe sfidat lidhur me rritjen e operativitetit dhe bashpunimit si dhe u trajtuan format e mundshme të organizimit (duke mos përjashtuar aspektet regjionale) në mes të NJIF-ve si përdorues të këtij sistemi në të ardhmen.

Konferenca është mbajtur në dy grupe të ndryshme punuese. Njëri nga takimet ka qenë i mbyllur për vendimarrësit ku kanë marrë pjesë udhëheqësit e NJIF-ve ose të deleguarit e tyre. Ky grup ka trajtuar çështjet lidhur me Operacionet dhe Politikat në të cilin u shqyrtuan skenare të mundshme të zhvillimeve lidhur me goAML. Ndërsa grupi tjetër kishte të bëjë trajnimin dhe me çështje të Teknologjisë Informative në të cilin janë trajtuar aspektet tekniko-funksionale të goAML, ku pjesëmarrës nga ana e NJIF-K ishte një ekspert i teknologjisë informative dhe i sistemit të goAML.



6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT

6.1. *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018*


Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar me 28 Janar 2014 Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018. Këto dokumente të politikave përbëjnë një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut kombëtar nga fenomenet e dëmshmetë trajtuara nga kjo strategji. Strategjia është e bazuar në të gjeturat e raportit mbi vlerësimin e rrezikut kombëtar ku janë identifikuar gjashtë objektiva kryesore:

1. Ngritja e vetëdijes për ndikimet në ekonominë joformale dhe krimeve financiare
2. Forcimin e parandalimit dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimeve financiare duke përmirësuar transparencën, llogaridhënien, qeverisjen e mire dhe partneritetin social
3. Promovimi i procedurave të inteligjencës, hetimit, ndjekjes penale, gjyqësore, dhe të zbatimit për shpëlarjen e parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare
4. Forcimi i kapaciteteve të Institucioneve Relevante
5. Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizimit dhe krimeve financiare
6. Zhvillimi i legjislacionit kombëtar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i zbatimit të tij efikas.

Krahas kësaj Strategjie Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një mekanizëm për hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare 2014-2018 është bazuar në Planin e Veprimit i cili është një udhërrëfyes që duhet të përcjellët në mënyrë që të arrihen objektivat strategjike. Plani i Veprimit përfshin gjithsej 51 aktivitete konkrete. Në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie, NJIF-K është një prej institucioneve kyçe për sa i përket implementimit të kësaj Strategjie dhe Planit të veprimit. Është autoriteti primar përgjegjës për shtatë (7) veprime të përcaktuara në planin e veprimit, përdërisa institucion mbështetës ishte i përfshirë në gjithsej njëzetedy (22) aktivitete. Aktivitetet kryesore të cilat NJIF-K pritet t'i implementoj si institucion përgjegjës në periudhën 2014-2018 janë me sa vijon:

1. Zbatimi i aktiviteteve mbikëqyrëse të pajtueshmërisë për të vlerësuar PPP/LFT duke raportuar pajtueshmërinë e subjekteve me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (aktiviteti 2.2.10).
2. Implementimi i vlerësimeve të rrezikut specifik për degën dhe sektorin, duke u fokusuar në degët dhe sektorët më të cënueshëm për sa i përket shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit. Duhet të vlerësohet dhe sigurohet pajtueshmëria e tyre me Ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit (akt. 2.2.11).
3. Organizimi i NJIF-K-së për të pasqyruar detyrat dhe kërkesat e reja të agjencisë të parashikuara me ligj duke u bazuar në ambientin e tij funksionues (akt. 2.3.1).
4. Krijimi i Procedurave Standarde Operative për aktivitetet e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë të NJIF-K (akt. 2.3.3).



5. Sigurimi i anëtarësimit të NJIFK-së në Grupin Punues Rajonal të NJIF-ve në rajon për ta rritur shkëmbimin ndërkombëtar të inteligjencës financiare dhe për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (akt. 2.5.1).
6. Sigurimi i anëtarësimit të NJIFK-së në Grupin Egmont të Njësive të Inteligjencës Financiare për të rritur shkëmbimin ndërkombëtar të inteligjencës financiare dhe për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (akt. 2.5.2).
7. Sigurimi i bashkëpunimit operativ të NJIF-K-së me NJIF-të e huaja përkatëse përmes nënshkrimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit për rritjen e shkëmbimit ndërkombëtar të inteligjencës financiare për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (akt. 2.5.3).

Gjatë vitit 2014 janë hartuar Raportet e gjendjes 1/2014 dhe 2/2014 dhe si dhe është draftuar raporti përfundimtarë vjetorë 03/2014 duke përdorur metodat direkte dhe indirekte, duke i kushtuar vëmendje kritereve subjektive dhe objektive. Raporti vjetorë i gjendjes 03/2014 pritet të miratohet nga Grupi Punues Qeveritar në pjesën e parë të vitit 2015.

Bazuar në raportet e gjendjes të publikuara në lidhje me implementimin e kësaj strategjie është konkluduar që rezultatet për vitin 2014 tregojnë se NJJIF-K ka përbushur dhe tejkaluar indikatorët kyç të performancës të përcaktuara në shtojcën 1 të planit të veprimit. Duhet theksuar që pavarësisht vështirësive në aspektin e numrit të stafit dhe mbështetjeve logjistike (hapësirat e punës), dhe poashtu mos pranimit të saj në Egmont group, NJJIF-K ka arritur që të tregojë një performancë jashtëzakonisht të mirë përgjatë vitit 2014 e cila është reflektuar edhe në të arriturat e ilustruara në raportet e publikuara.

6.2. Vlerësimi Rrezikut Sektorial 2014

Pas përfundimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2013, i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 18.12.2013, përfshin përfundimin se ekonomia joformale, pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe krimet financiare janë pandashëm të lidhura me njëra tjetrën. Në anën tjetër, Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare 2014-2018 kërkon që autoritetet përkatëse me mbështetje të institucioneve tjera relevante duhet të implementojnë vlerësimin e rrezikut të sektorit dhe degëve specifike me fokus në sektorët dhe degët më të cenuara në ekonominë joformale dhe krimeve financiare. Kështu, NJJIF-K vendosi të kryej vlerësimin e rrezikut të sektorit specifik në mënyrë që një proces i till do të identifikoj kërcënimet dhe dobësitë që kanë lidhje me ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare.

NJJIF-K në Mars 2014 ka filluar Vlerësimin e Rrezikut të Sektorit Specifik në Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit në Kompanit e Ndërtimit në Kosovë 2014. Njësia vendosi që të fokusoj procesin në kompanit e ndërtimit pasi është konsideruar të jetë njëri prej sektorëve më të cenueshëm në pastrim të parave.

NJJIF-K ka propozuar themelimin e Grupit Punues të Vlerësimit të Rrezikut të përbërë nga përfaqësues të institucioneve relevante të sektorit publik dhe privat. Anëtarët e grupit të ngushtë punues përveç NJJIF-K ishin të përbërë nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Administrata Tatimore e Kosovës, Policia e Kosovës, si dhe Projekti i



financiar nga BE “Mbështetje institucioneve të Kosovës në luftimin e krimeve financiare dhe ekonomike. Në mënyrë që të mbledh të dhëna, Grupi Punues i Vlerësimit të Rrezikut ka komunikuar dhe konsultuar me një rrjet të gjerë të partnerëve. Të gjitha burimet relevante subjektive dhe objektive janë përdorur.

Pasoja dhe mundësia e secilit rrezik të identifikuar është analizuar ndaras duke përdorur Metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikut të Bankës Botërore, ndërsa informatat e mbledhura janë vlerësuar duke përdorur sistemin 4x4 të Europolit.

Ky vlerësim i rrezikut ka për qëllim të përdoret për hartimin, rishikim dhe amendamentim të politikave kombëtare, strategjive dhe instrumenteve tjera të menaxhimit të rrezikut. Në anën tjetër, rezultatet e vlerësimit të rrezikut duhet të përdoren gjatë fokusimit të aktiviteteve strategjike dhe operacionale të NJIF-K.

6.3. Mekanizmi kombëtar i menaxhimit të rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit

Gjatë dy viteve të fundit Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar një numër të caktuar të dokumentave strategjikë dhe ka krijuar mekanizmin kombëtar të menaxhimit të rrezikut në ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Në të gjitha këto projekte strategjike, NJIF-K së bashku me institucionet tjera relevante, kanë mbështetur dhe hartuar dokumentet relevante. Procedura e ndjekur në Kosovë për menaxhimin e rrezikut është bazuar në Udhëzimet e FATF të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe standardet ndërkombëtare ISO 31000⁵ dhe 31010⁶. Kjo njëherit është bazuar në konsultimet dhe komunikimet me një rrejt të zgjeruar duke përfshirë me këtë rast partnerët nga institucionet më relevante të sektorit publik dhe privat. Për hartimin e këtyre dokumentave strategjike ka qenë shumë e rëndësishme edhe rritja e partneritetit mes këtyre institucioneve, dhe një gjë e tillë është arritur me shumë sukses, ku përveç sektorit publikë, një kontribut të çmuar në këtë drejtim ka dhënë sidomos sektori privat, shoqëria civile dhe organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të instaluar në Kosovë.

Ky mekanizëm i menaxhimit të rrezikut përmban dokumentet si në vijim:


- Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit Kosovë 2013;
- Matrica e Analizimit dhe Vlerësimit për Rreziqet Individuale të Identifikuara në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut 2013;
- Plani i Veprimit për Masat e trajtimit të rreziqeve të identifikuara në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, Kosovë 2013;
- Vlerësimit e Rrezikut sektorial në ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare në Kosovë;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018;

⁵Menaxhimi i Rrezikut – Parimet dhe udhëzimet, Standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

⁶Menaxhimi i Rrezikut – Teknikat e vlerësimit të rrezikut, Standardet Ndërkombëtare ISO 31010, 2009.



- Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018;
- Planet e Buxhetit dhe Performancës së institucioneve relevante publike 2014-2018;
- Platforma që siguron partneritetin mes institucioneve të sektorit publik, privat dhe të tretë sa i përket hartimit, rishikimit, adoptimit, implementimit dhe monitorimit të instrumenteve të menaxhimit të rrezikut;
- Raporti i Situatës që hartohet çdo tre (3) muaj dhe që përmban informata për statusin dhe rezultatet e procesit të implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 dhe informata bazuar në situatën aktuale dhe zhvillimet sa i përket performancës operative dhe rezultateve në parandalimin e ekonomisë joformale dhe pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare.



7. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

7.1. *Bashkëpunimi me EULEX-in*

NJIF-K dhe EULEX kanë pasur një bashkëpunim të mirë dhe të frytshëm. Edhe gjatë vitit 2014 në Njësinë për Inteligjencë Financiare ka vazhduar prezenca e stafit të misionit të EULEX-it. Katër punonjës të atij misionit, në mesin e tyre një këshilltar i Drejtorit të NJIF-K, dy analistë të Inteligjencës dhe një zyrtarë mbështetës kanë vazhduar të japin kontributin e tyre duke ndihmuar institucionin në zbatimin e mandatit ligjor dhe ngritjen e bashkëpunimit dhe kapaciteteve në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Prezenca e tyre në NJIF-K ka vazhduar deri në Tetor 2014, ku për shkak të shkurtimit të stafit ata zyrtarë kanë përfunduar misionin e tyre në Eulex përkatësisht në NJIF-K.

7.2. *Projektet e financuar nga BE-ja*

Projekti i titulluar “Mbështetje institucioneve të Kosovës në luftimin e krimit financiar dhe ekonomik” financohet nga BE-ja. Menaxhohet nga zyra e BE-së në Kosovë. Implementimi është realizuar prej ana e kompanisë B&S Europe.

Objektiva e përgjithshme e Projektit është mbështetja e autoriteteve të Kosovës për të përforcuar sundimin e ligjit përmes mbështetjes së mëtutjeshme të zbatimit të përgjithshëm të ligjit dhe luftimit të përgjithshëm të krimit të organizuar me fokus në krimin financiar dhe ekonomik.

Përfituesit primar të aktiviteteve të Projektit janë Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Ministria e Financave. Përfitues indirekt janë Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, prokurorët, gjyqtarët dhe partnerët tjerë relevant.

Projekti përmban në vete tri (3) komponente kryesore dhe katër (4) shtesë që gjithsej arrinin në shtatë (7) Komponente. Ato janë të ndara në gjithsej 35 aktivitete që përmbajnë dizajnimin e kornizës ligjore dhe kornizës rregullative, ngritjes së kapaciteteve të NJIF-K dhe institucioneve tjera relevante, ndërgjegjësimi dhe zbatimi i strategjisë, vlerësimi i ekonomisë joformale, çertifikimi i Ekspertëve Financiare, çertifikimi i Ekspertëve Kompjuterik dhe rishikimi i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

Ekipi i Projektit të BE-së po ashtu ka mbështetur NJIF-K dhe institucionet tjera të sektorit publik, privat dhe të tretë në krijimin e mekanizmit të menaxhimit të rrezikut në ekonomin joformale, pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe krime financiare. Ai përmban Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut në Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit 2013 që është hartuar nga grupi punues i udhëhequr nga NJIF-K dhe është aprovuar nga Qeveria e Republikës. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut ishte baza për procesin që rezultojë në hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018.

Ekipi i Projektit të BE-së dhe NJIF-K kanë iniciuar proceset që do të rezultojnë në zhvillimin e vlerësimit të ekonomisë joformale të hirt dhe të zezë, çertifikimin e Ekspertëve Financiar,

certifikimin e Ekspertëve Kompjuterik dhe rishikimin e Ligjit të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Këto aktivitete janë finalizuar gjatë vitit 2014.

Komisioni i BE-së ka kryer monitorimin e projektit ku ka marrë komente të shkëlqyeshme në bazë të vlerësimit. Në anën tjetër, rezultatet e misionit të monitorimit kanë demonstruar bashkëpunimin dhe koordinimin e shkëlqyeshëm ndërmjet Ekipit të Projektit, përfituesve dhe partnerëve gjatë implementimit të aktiviteteve të projektit. Ky partneritet ka siguruar një proces efikas dhe efektiv i cili ka rezultuar me ndikime relevante për parandalimin e krimit ekonomik dhe financiar dhe në dorëzimin e outputeve të Projektit tek institucionet relevante kombëtare duke siguruar kështu qëndrueshmërinë e procesit.

7.3. Projekti i BE&KE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë PECK”

7.3.1. Cikli i dytë (II) i vlerësimit mbi pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT)

Një vlerësim mbi pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT) është përgatitur nga Projekti i Përbashkët i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK), i zbatuar duke filluar nga 1 shkurti 2012 deri më 31 mars 2015. Raportet e këtij vlerësimi janë publikuar dhe është nxjerrë edhe një plan i veprimit për trajtimin e rekomandimeve të dalura nga të gjeturat e këtij vlerësimi. Vlerësimi përfshin dy komponentë: Luftimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT), si dhe Luftimin e Korrupsionit (LK), të cilat janë vlerësuar në kuadër të një procesi të vetëm të integruar.

Vlerësimi i sistemit të Kosovës në luftimin e pastrimit të parave dhe në luftimin e financimit të terrorizmit është bazuar në Rekomandimet e FATF-së të vitit 2003 dhe në Rekomandimet e veçanta mbi Financimin e Terrorizmit të vitit 2001 të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF)⁷ dhe është përgatitur duke përdorur metodologjinë e vlerësimit LPP/LFT 2004. Pyetësor të ndarë, po ashtu të bazuar në Metodologjinë e FATF, janë përgatitur për dy ciklet e vlerësimit dhe kanë paraqitur bazën për dy vizitat në terren.

Gjatë ciklit të dytë të vlerësimit, ekipi i vlerësimit ka zhvilluar një vlerësim mbi përputhshmërinë e Kosovës me Rekomandimet e FATF.

Për më tepër, në raport mbulohej gjithashtu një mori çështjesh të përzgjedhura në lidhje me Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 26 tetor 2005, për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe Direktiva 2006/70/EC e Komisionit të datës 1 gusht 2006, mbi vendosjen e masave implementuese për Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian në lidhje me definicionin e “personave të ekspozuar politikisht” dhe kriterëve teknike për procedura të thjeshtësuara të kujdesit të duhur të klientit dhe për përjashtimin mbi bazat e aktivitetit financiar të kryer në baza të rëndomta dhe shumë të kufizuara, si dhe një mori elementesh të

⁷ Ky raport nuk është i bazuar në rekomandimet e korigjuara të FATF, të cilat janë nxjerrë në shkurt të vitit 2012.



Konventës së Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit (STKE 198). Vlerësimet të këtyre çështjeve i është caktuar edhe klasifikimi.

Të dy ciklet e vlerësimit janë bazuar në ligje, rregullore dhe materiale të tjera të siguruara nga autoritetet, si dhe në informatat e siguruara nga ekipi i vlerësimit dhe rrjedhimisht pas vizitës së tij në Prishtinë në vitin 2012 për ciklin e parë të vlerësimit, dhe nga 14 deri më 18 prill 2014 për vlerësimin e dytë. Gjatë vizitave në terren, ekipi i vlerësimit është takuar me zyrtarë dhe përfaqësues të ministrive dhe agjencive përkatëse, si dhe të sektorit privat në Kosovë.


Ekspertët bënë shqyrtimin e kornizës institucionale, të ligjeve, rregulloreve, udhëzuesve dhe të kërkesave të tjera të LPP/LFT-së, si dhe të rregullatorëve dhe sistemeve të tjera të krijuara për pengimin e Pastrimit të Parave (PP) dhe Financimit të Terrorizmit (FT) përmes institucioneve financiare, dhe Biznese dhe Profesioneve të Caktuara Jo Financiare (BPCJF-të) si dhe bënë ekzaminimin e kapacitetit, zbatimit dhe efikasitetit të të gjitha këtyre sistemeve.

Struktura e këtij Raporti gjërësisht përcjell strukturën e Raporteve të vlerësimeve të Raundit të Tretë të MONEYVAL dhe FATF.

Ky raport ofron një përmbledhje të masave LPP/LFT të krijuara dhe të ndërmarra nga autoritetet lokale në Kosovë në datën e vizitës apo menjëherë pas saj. Raporti bën përshkrimin dhe analizën e këtyre masave, përcakton nivelet e pajtueshmërisë së Kosovës me rekomandimet FATF-së, dhe ofron rekomandime se si mund të përmirësohen aspekte të caktuara të sistemit

7.3.1.1. Vizita në teren e ekipit të vlerësimit të projektit PECK në Kosovë

Në periudhën nga data 14 deri më 18 Prill 2014, është zhvilluar në Prishtinë vizita e dytë në teren nga ekspertët vlerësimit të angazhuar nga projekti i përbashkët i BE & KiE, për të vlerësuar kornizën dhe sistemin e gjithmbarshëm të luftës kundër pastimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë. Qëllimi i kësaj vizite ishte shikimi i një pasqyre më të saktë përmes verifikimit dhe shtejllimit të pyetsorit të dërguar nga autoritetet në vend në ciklin e dytë (2) të vlerësimit, si dhe për të mbledhur edhe më tepër informacion shtesë mbi zbatimin e rekomandimeve të dalura nga cikli i 1 për të dy komponentët kundërr korripsionit dhe pastrimit të parave/financimit të terrorizmit. Ekipi vlerësues zhvilloi takime me një numër të gjerë të autoriteteve duke përfshirë përfaqësues nga institucionet qeveritare, sektorin bankar dhe financiar, insitucionet tjera jo-financiare dhe profesionët në fjalë që kanë obligim të raportojnë në lidhje me PPP/PFT, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile. Informacioni i mbledhur gjatë vizitës në teren do të ndihmojë Ekipin e Vlerësimit për të bërë një gjykim sa më të saktë dhe të balancuar mbi përputhshmërinë e kornizes ligjore e institucionale me standardet ndërkombëtare të LPP/LFT, dhe së bashku me përgjigjet ndaj pyetësorit dhe informacion shtesë të ofruara pas vizitës në terren, do të shërbente si bazë për hartimin e raporteve të vlerësimit përfundimtar për Kosovën.




7.3.1.2. *Takim mes autoriteteve të Kosovës dhe ekipit të vlerësimit në Strasburg*

Më 3 dhe 4 nëntor 2014, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës ishin për takim pune në Strasburg, meçrast u takuan me ekipin e vlerësimit të Projektit PECK, në të cilin u diskutuan raportet e vlerësimit përfundimtar në përputhje të Kosovës me standardet ndërkombëtare në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në takim janë ngritura për diskutim dhe janë identifikuar çështjet për takimin plenar të publikimit të raporteve të vlerësimit. Përveç kësaj, pjesëmarrësit patën mundësi të njihen më mirë veten e tyre me punën dhe funksionimin e GRECO, Moneyval-it dhe CEPEJ përmes prezantimeve të përgaditura nga anëtarëve përkatës të sekretariatit të Këshillit Evropës.



Takim ballë për ballë mes autoriteteve të Kosovës dhe ekipit të vlerësimit në Strasburg, Nëntor 2014



7.3.1.3. *Takim Plenar i PECK për raportet e vlerësimit*




Më 2 dhe 3 dhjetor 2014, është mbajtur konferenca dhe takimi plenar i projektit për publikimin dhe miratimin e dy (2) raporteve të Vlerësimit të ciklit të dytë (2) mbi përputhshmërinë e Kosovës me standardet ndërkombëtare në fushën kundër-korrupsion (KK) dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (LPP/LFT) të përgatitura mbi bazën e GRECO dhe FATF dhe të bazuara në metodologjinë e MONEYVAL.

Pjesmarrës në këtë konferencë ishin rreth 65 përfaqësues të institucioneve relevante, ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësues nga ana e organizatave ndërkombëtare, sektorit privat dhe shoqërisë civile, të cilët njëherit ishin të angazhaur dhe morën pjesë në diskutime të frytshme. Miratimi i Raporteve të Vlerësimit shënon përfundimin e ushtrimit të vlerësimit të kryer nga Projekti në dy cikle në periudhën shtator 2012 deri dhjetor 2014.

Raportet e vlerësimit do të publikohen dhe shpërndahen tek të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë edhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, sektorin privat dhe shoqërinë civile, pas përfundimit dhe prezantimit të atij raporti tek niveli i lartë drejtues i cili planifikohet të mbahet në gjysmën e parë të vitit 2015.

7.3.1.4. *Seminar mbi mbledhjen e të dhënave, mirëmbajtjen dhe raportimin e statistikave për qëllime të vlerësimit*

Duke parë mangësitë e identifikuar gjatë ciklit të parë (1) të vlerësimit në mesin e të cilave ishte edhe mungesa e statistikave adekuate dhe harmonizimit të tyre ndërmjet institucioneve në lidhje me përpunimin e statistikave që kanë të bëjnë me krimet ekonomik, projekti në bashkëpunim me institucionet koordinuese nga të dy komponentët, në muajin Shkurt 2014, organizuan në funksion të kësaj një punëtori dy ditore në Prishtinë, mbi praktikën më të mira dhe mësimet të nxjerra nga Kosova, të fokusuar në mbledhjen e të dhënave, mirëmbajtjen dhe raportimin e statistikave për qëllime të vlerësimit. Rreth 50 përfaqësues të të gjitha institucioneve relevante, duke përfshirë edhe 7 gjykatat themelore dhe prokuroritë në Kosovë, morën pjesë në këtë punëtori duke dhënë informacion mbi gjendjen aktuale për sa i përket statistikave në institucionet e tyre përkatëse. Dy ekspertë të Këshillit të Evropës prezantuan praktikën më të mirë të mbajtjes së shënimeve në lidhje me krimet kryesore (duke përfshirë metodologjinë, bazën ligjore dhe sigurimin e cilësisë) dhe prodhimin e statistikave të besueshme, interaktive dhe të integruar për ndjekjen dhe gjetjen rasteve të krimeve ekonomike në bazë të përvojave dhe praktikave në Mbretërinë e Bashkuar dhe Holandë.



7.3.1.5. Konferenca Ndërkombëtare mbi Përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Me 23 shtator 2014, është orgaznizuar nga projekti PECK konferenca ndërkombëtare për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën PFT/LFT. Konferenca mbledhi së bashku rreth 50 përfaqësues të FIU-ve, gjykatave dhe prokurorisë, nga autoritetet tjera të zbatimit të ligjit, sektori privat dhe institucionet tjera ndërkombëtare, si dhe homologët e tyre të huaj nga vendet anëtare të BE dhe vendet fqinje. Organizimi i kësaj konference kishte për qëllim këmbimin të përvojave, praktikave më të mira dhe këshillat për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndihmën e ndërsjellë juridike në luftimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Agjenda e konferencës ishte e ndarë në tri sesione:

1. Bashkëpunimi ndërkombëtar në mes të NJIF-ëve

- *Modalitetet dhe praktikave e mira administrative (joformale) dhe shkëmbimi i informacioneve në mes të NJIF-ëve (parakushtet për bashkëpunim efektiv, karakteristikat kyçe ligjore dhe praktike, praktikave e mira)*
- *Intervenimet dhe shembuj të rasteve studimore*

2. Bashkëpunimi ndërkombëtar në mes të autoriteteve të zbatimit të ligjit

- *Modalitetet, standardet dhe praktikave e mira të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndarja e informacioneve në mes të autoriteteve të zbatimit të ligjit në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të pastrimit të parave- bashkëpunimi përmes ILECU dhe INTERPOL-it*
 - *Format e bashkëpunimit bilateral (ndihma policore, ndarja e informacioneve, kanalet e bashkëpunimit, bashkëpunimi gjatë hetimeve);*
 - *Praktika e letërporosive dhe ekipet e hetimeve të përbashkëta;*
 - *Statusi i gjendjes: përvoja bilaterale, përfshirja në rrejetet ekzistuese, iniciativat dhe projektet, planet dhe mundësitë e ardhshme.*

3. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar

- *Rishikim i standardeve ndërkombëtare dhe modaliteteve të Ndihmës së Ndërsjellë Juridike (NNJ);*
- *Shkëmbimi i këndvështrimeve, përvojave dhe praktikave të mira të dhënies së NNJ-së, trajtimit të kërkesave të ekstradimit dhe ndërmarrjes së ngrirjes dhe konfiskimit;*
- *Intervenimet dhe rastet studimore.*

Përfaqësues nga Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Gjermania, Hungaria, Italia, Mali i Zi dhe Mbretëria e Bashkuar ndanë përvojat e tyre dhe prezantuan studime të rasteve praktike të ndjekura nga diskutimet. Kjo ngjarje ka kontribuar në krijimin dhe forcimin e kontakteve dhe nxitjen e bashkëpunimit në mes të autoriteteve të Kosovës dhe homologëve të tyre të huaj.





Konferenca Ndërkombëtare mbi Përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën LPP/LFT

7.4. Mbështetja nga Thesari i Shteteve të Bashkuara

Departamenti i Thesarit Amerikan në Kosovë, ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut të çmuar në ngritjen e kapaciteteve duke ofruar këshillime dhe asistencë në lidhje me luftën kundër shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, mandatin ligjor dhe operacional të NJIF-it dhe rëndësinë e mbështetjes nga NJIF për institucionet tjera të zbatimit të ligjit. Kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim ka dhënë udhëheqësi i departamentit ekonomikë pranë thesarit ameriakn..

Organizimi i përbashkët i punëtorisë “përcjell paratë” në mes të Institutit kundër Krimeve Ekonomike pjesë e së cilës është edhe NJIF-K dhe Zyrës për Asistencë Teknike të Thesarit, ka rezultuar shumë i sukseshëm duke dhënë inputet e para dhe efektive në vetëdijësimin e Prokurorive dhe autoritetet tjera të ndjekjes penale nëpër shtatë regjione të vendit. Kjo punëtori ka pasur si synim ngritjen e vetëdijes për ndrëlidhjen e veprave penale dhe njoftimin më për së afërmi mes institucioneve të zbatimit të ligjit.



8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K 2015-2017

Në fund të vitit 2014, menaxhemti i NJIF-K ka rishikuar planin e saj strategjikë përkatësisht rezultatet dhe implementimin e Planit të saj të performances dhe resurseve 2014-2016 dhe njëherit ka hartuar Planin e ri të performances dhe resurseve 2015-2017.

Pas një vlerësimi që është bërë për përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të parapara në atë plan strategjikë është konstatuar se thuajse gjitha aktivitetet janë përmbushur me sukses nga NJIF-K. Para së gjithash ka rezultuar se ka:

- ngritje të vetëdijësimit dhe komunikimit për luftën kundër shpërlarjes së parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
- fuqizim të parandalimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit përmes fuqizimit të mbikqyrjes së pajtueshmërisë dhe mekanizmave të vlerësimit të rrezikut;
- është bërë standardizimi dhe intensifikimi i raportimit, inteligjencës dhe proceseve të analizës si dhe kishte ngritje në vazhdimësi të bashkëpunimit me shumë-agjenci sa i përket zbulimit dhe hetimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe konfiskimi i të ardhurave të krimit;
- është hartuar koncepti dokumenti për ndryshimet ligjore në KPP/LFT, janë nxjerrë akte nënligjore si dhe janë hartuar disa procedura standarde të operimit të NJIF-K dhe është bërë sigurimi i implementimit efikas të tyre;
- në vitin 2014 kishte qasjes shumë më proaktive për bashkëpunimin ndërkombëtarë në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke pasur ngritje të kërkesave për informata të pranura (nga 7 në 19) dhe shpërndara (nga 6 në 20) si dhe nënshkrime të reja të marrëveshjeve të bashkëpunimit;
- ngritja e kapaciteteve të NJIF-K ka vazhduar edhe në atë vit duke ndejkur trajnime dhe konferenca të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare.

Në fund të vitit 2014 pas rishikimit të planit të performances dhe harmonizimit të tij me Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, NJIF-K ka draftuar Planin e saj të Performancës dhe Resurseve 2015-2017. Ky dokument strategjik përshkruan detyrat, misionin, vizionin, qëllimet, objektivat dhe veprimet e Njesisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NJIF-K). Plani gjithashtu përmban parashikimin për alokim të resurseve dhe kontroll të brendshëm.

Plani i performancës dhe resurseve 2015-2017 përcakton se si NJIF-K do të bazohet dhe ndërtoj asetet e saj dhe të arriturat për t'i përmbushur dhe tejkaluar sfidat me të cilat do të ballafaqohet gjatë periudhës tri vjeçare dhe se si do të mirëmbajë pozitën e vet si një ndër njësitë efikase të inteligjencës në Kosovë dhe në rajon. Ky plan gjithashtu tregon se si NJIF-K do të matë suksesin e vet dhe si do të kontrollojë proceset e veta të brendshme.




Kapitujt kryesor të përfshirë në atë Plan të Performancës dhe Resurseve janë paraqitur si në vijim:

1. Prezantim detyrave, misionit, vizionit, qëllimeve strategjike dhe organizimit të njësisë si dhe objektivat, planet e veprimit dhe indikatorët e performancës;
2. Mjedisi Operativ i NJIF-K dhe Vlerësimi i Rrezikut;
3. Objektivat, zyrarët përgjegjës, planet e veprimit dhe indikatorët e performancës;
4. Burimet Financiare, Njerëzore dhe të Teknologjisë Informative dhe Plani i objektit dhe zyreve për NJIF-K.

Njëherit, Plani i Performancës dhe Resurseve 2015-2017 definojnë objektivat strategjike të NJIF-K. Ai gjithashtu përmban planet se si t'i arrij ato dhe indikatorët kyç të performancës për të matur efikasitetin e njësisë. Janë përcaktuar 6 objektivat kryesore strategjike të NJIF-K për periudhën 2015-2017, të cilat janë paraqitur siç vijon:

1. Objektivi 1 – Rritja e vetëdijësimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
2. Objektiva 2 – Promovimi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe intensifikimi i mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;
3. Objektiva 3 – Zhvillimi, standardizimi dhe intensifikimi i proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave dhe promovimi i bashkëpunimit të agjencioneve për detektimin dhe hetimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit si dhe konfiskimit të të ardhurave nga krimi;
4. Objektiva 4 – Zhvillimi i legjislacionit kombëtar PPP/LFT dhe standardeve të brendshme të NJIF-K dhe sigurimi i implementimit të tyre efikas;
5. Objektiva 5 – Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
6. Objektiva 6 – Rritja e kapacitetit të NJIF-K.

Plani i Performancës dhe Resurseve 2014-2016 përmban gjithashtu burimet financiare (buxhetin e NJIF-K), burimet njerëzore, Vlerësimin e performancës dhe ndërtimin e kapaciteteve të personelit të NJIF-K, teknologjinë informative dhe hapësirën punuese.





Rr. Eduard Lir Nr.1 – Arbëri – Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103

<http://fiu.rks-gov.net>

fic@fic-ks.org